



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

### PROJEKTRAPORTI I AUDITIMIT FINANCIAR

**Pasqyra e Lëndës ..... Fq. 1**

**PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE ..... 2**

1.1 Hyrje ..... 2

1.2 Medota e auditimit ..... 2-3

1.3 Gjetjet kyçe ..... 3-5

1.4 Zbatimi i rekomandimeve të lëna ..... 5

**ANEKSI A – MBULIMI I AUDITIMIT ..... 5-41**

**ANEKSI B – GJETJET NGA AUDITIMI ..... 41-47**

**ANEKSI C – ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA MË PARË ..... 47-48**



## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

### 1.1 Hyrje.

I përgatitur më datë 25.11.2013 nga përfaqësuesit e autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit audituesit Faik qosja, Valdete Berisha dhe Dritan Kore në Autoritetin e Mediave Audiovizive Tiranë përfaqësuar nga znj. Endirë Bushati, me detyrë Kryetare e KKRT-së, për auditimin e ushtruar me objekt: “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar”.

Auditimi u krye në bazë të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, nga data 21.10.2013 deri më 12.11.2013, sipas drejtimeve të përcaktuara në Programin e Auditimit nr.849/1, datë 18.10.2013, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u krye për pasqyrat financiare fundit për 2011,2012, dhe 9/mujori vitit 2013 bazuar në dokumentet e mëposhtëme:

- bilancin kontabël;
- pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta;
- pasqyrën e rrjedhjes së parasë;
- anekset e pasqyrave financiare dhe dokumentat e tjera shpjeguese.

Gjatë ushtrimit të auditimit, i cili përfshiu periudhën nga data 01.01.2011 deri më datën 30.09.2013 dhe formulimit të këtij projektraporti, grupi i auditimit ka zbatuar *Kodin Etik dhe standardet e miratuara të kontrollit*.

***Si konkluzion***, Autoriteti i Mediave Audiovizive operon me të ardhurat e veta pa financim nga buxheti i shtetit, nga viti 2006 dhe paraqet me një performancë të mirë në menaxhimin e shpenzimeve, pasi ka menaxhuar drejt veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit, ka administruar siç duhet vlerat materiale dhe monetare, bazuar në rregullat dhe standardet financiare.

*Raportimet financiare paraqesin në mënyrë të drejtë të gjitha aspektet materiale e monetare të institucionit, pasi ka bërë të mundur arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë por, ka nevojë edhe për disa përmirësime të trajtuara sipas gjetjeve nga auditimi.*

### 1.2 Metoda e auditimit.

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon Drejtoria ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Licencave, Drejtoria e programeve, Drejtoria teknike dhe pas marrjes së informacionit në mënyrë të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, për të parë nëse ekzistojnë gabime, parregullsi dhe veprime të paligjshme. Gjatë planifikimit parashikuam që zonat me risk ndodhen tek investimet, blerjet e mallrave dhe përdorimi i vlerave monetare, për periudhën objekt auditimi institucioni ka përdorur fonde të miratuara nga Këshilli i Ministravë dhe konkretisht, për vitin 2011, ka planifikuar 89,070 mijë lekë dhe përdorur në fakt 83,787 mijë lekë, për vitin 2012, ka planifikuar 98,400 mijë lekë dhe përdorur në fakt 81,844 mijë lekë dhe për vitin 2013, ka planifikuar 108,100 mijë lekë, ka përdorur për 9/mujorin 57,252 mijë lekë, kato shpenzime janë mbuluar me të ardhurat e veta, risku është i nivelit të ulët.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Gjithashtu, për tu siguruar që fondet janë të plota dhe të vlefshme, si dhe për të parë nëse veprimet janë të rregullta, të plota dhe të regjistruara, u audituan zonat e llogarisë 600 “Pagat”, 601 “Sigurimet shoqërore”, 602 “Mallra e shërbime”, 230+231 “Investime”, inspektimet, paisja me licenca të operatorëve, zona e të ardhurave dhe tregues të tjerë financiar.

Institucioni nuk ka strukturë të auditimit të brendshëm, por ka grupet e inspektimit.

*Për zbatimin e auditimit u mbështetëm në dispozitat ligjore si më poshtë:*

- Rregullore “KKRT-së dhe administratës së saj” miratuar me vendim nr.12, datë 26.06.2000.
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr.97/13, datë .....
- Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetëror edhe enteve publike”.
- Ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
- Vendimi i KM nr 184, datë 19.05.2008 “Për miratimin e strukturës , organikës dhe kategorizimin të pozicioneve të ounës të KKRT-së”
- Vendimin i KM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qëndrore si dhe njërive që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998”.
- Vendimin i Këshillit të Ministrave nr. 475, datë 13.07.2007 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të zgjedhjeve”, i ndryshuar.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
- Vendimin i Këshillit të Ministrave nr. 545, datë 11.08.2011, i ndryshuar.
- Akte të tjera nënligjore të dala në zbatim të tyre, etj.

### ***1.3 Gjetjet kyçe të auditimit dhe impakti i tyre tek pasqyrat financiare.***

**1.3.1.** Nga auditimi i shpenzimeve për vitin 2011 dhe 2012 rezultoi se, për ndërprerjen e marrëdhënieve nga puna pa shkaqe të arësyeshme të 11 punonjësve, janë ekzekutuar vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil dhe vendimet e gjykatave për periudha 01.01.2011 deri më 31.12.2012 likujduar shuma prej 14,629,828 lekë që ka sjell një efekt negativ financiar për buxhetin e institucionit, për largimet nuk janë zbatuar procedurat, në kundërshtim me Ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 për “Statusi i Nënpunësit Civil”, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 6-7 të Projekraportit të Auditimit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

**1.3.2** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se:

a) Në “Pasiv” grupin B nuk janë pasqyrtuar detyrimi që ka AMA ndaj tatim taksave në fund të periudhës.

**Për vitin 2011**, janë arkëtuar nga subjektet taksa 16,081,620 lekë, derdhur për llogari të tatim taksave vlera 15,258,049 lekë diferenca mbetur gjendje 31.12.2011 vlera 823,571 lekë, kjo duhej pasqyruar në llogarinë 432, likujdimi është bërë në vitin pasardhës.

**Për vitin 2012**, arkëtuar nga subjektet taksa 12,284,111 lekë, derdhur për llogari të tatim taksave vlera 10,398,911 lekë diferenca mbetur gjendje 31.12.2011 vlera 1,885,200 lekë, kjo duhej pasqyruar në llogarinë 432 se likujdimi është bërë në vitin pasardhës.

b) Dorzimi i pasqyrave financiare nga operatorët e radiotelevizionet private sipas nenit 8 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.2008 “Për Radion dhe Televizionin Publik e privat në Republikën e Shqipëtarë”. Viti 2011 nga 220 operatorë kanë dorëzuar 128 ose 59 %, viti 2012 nga 250 operatorë kanë dorëzuar 103 operatorë ose 41 % e tyre, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 7-10 të Projekraportit të Auditimit.

**1.3.3.** Nga auditimi i pagesave për raportet mjekësore punonjësvë rezultoi se, nuk është mbajtur tatimi mbi të ardhurat për raportet deri në 14 ditë, sipas ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 8483, datë 28.12.199

“Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 8 pika b. sipas të cilit të ardhurat që i merr i punësuar për 14 dite e para me raport mjekësor, nuk janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale, **vlera e patatuar është 1,306,830 lekë x 10% tatimi = 130,683 lekë për 24 punonjës**, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 13-14 të Projekraportit të Auditimit.

**1.3.4.** Gjatë auditimit lëvizjes së arkës në lekë dhe në valutë, rezulton se arka ka qënë me gjendje më 31.12.2011 dhe 31.12.2012, kjo bie në kundërshtim me udhëzimi nr.30 datë 27.11.2011 “për menaxhimin e vlera materiale dhe monetare “ **,pra në cdo fund vitit duhet të bëhë derdhje në bankë dhe gjendja e arkës duhet te jetë zero (0)**, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 14-15 të Projekraportit të Auditimit.

**1.3.5.** Nga verifikimi i vlerave të kaluar me xhirim nëpërmjet bankës, me urdhrat e prokurimit të nxjerrë nga titullari, për blerjeve me vlera te vogla, nuk plotësohet formulari nr. 3, për testimin e tregut, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, indryshuar, kreu VI, pika 2. “Për blerjet me vlera të vogla”, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 16-18 të Projekraportit të Auditimit.

**1.3.6.** Nga auditimi i pagave rezultoi se, punonjësve është paguar orë pune shtesë mbi kohën normale periudha Janar 2011-30.09.2013, me një vlerë 1,081,568 lekë, të bazuar në vendimit nr.511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen në punë”, por në kundërshtim me vendimin nr.472 datë 2.07.2011 “Për disiplinimin e fondeve për orët e e punës të kryera mbi mbi kohën normale”, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 18-20 të Projekraportit të Auditimit.

**1.3.7.** Nga auditimi Pagesave për udhëtim e dietave të punonjësve, për shërbimet e kryera jashtë qendrës së punes, brenda vendit, në disa urdhër shërbimet ka manges të dokumentacioni shoqërues, në kundërshtim me vendimin nr.997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

*dërgohën me sherbim jashtë qendrës së punës* “, është paguar padrejtësisht vlera 232,000 lekë për 14 punonjë, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 20 të Projekraportit të Auditimit.

**1.3.8.** Në fund të vitit 2012 AMA ka dhënë shpërblim punonjësve nga fondi i vecantë me vlerë 1.203.195 lekë, paguar 32 punonjë, pagesa është bërë sipas vendimit nr.929 date 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë “, por në kundërshtim me *vendimin nr.849 datë 16.12.2012 ,ku në pikën nr 9 theksohet “Përyjashtimisht për vitin 2012 fondi i veçantë nuk përdoret për shpërblimet e punonjësve* “, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 20-21 të Projekraportit të Auditimit.

**1.3.9.** Nga auditimi i lëvizjeve të vlerave materiale dhe monetare rezultoi se, mungon dokumentacioni për 3,949 litra karburant me vlerë 641,273 lekë, që del si diferencë nga krahasimi i dokumentacionit me hyrje dhe daljet nga magazina, në kundërshtim me ligjin nr.6942, datë 25.12.1984, Udhëzimit nr.70, datë 11.03.1985 me ndryshime, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011. Për këtë shumë rekomandojme që shuma prej 641,273 lekësh, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 21-22 të Projekraportit të Auditimit.

**1.3.10.** Nga auditimi për likuidimin e gjobave të vendosura e nga KKRT, në zbatim të nenit 10/a dhe 137/1 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.2008 “Për Radion dhe Televizionin Publik e privat në Republikën e Shqiptarë”, autoriteti ka arkëtuar vlera minimale nga saksionet si më poshtë:

**Për vitin 2011**, vlera e gjobave për tu paguar 30,710 mijë lekë nga 71 raste, paguar 6 subjekte vlerën 1,400 mijë lekë ose 5% e totalit mbeten pa arkëtuar 29,310 mijë lekë.

**Për vitin 2012**, vlera për tu paguar 17,880 mijë lekë nga 63 raste, paguar 3 subjekte vlerën 460 mijë lekë, mbeten për arkëtim 17,420 mijë lekë.

Totali për dy vite 46,730 mijë lekë, vlera këto të pa rregjistruara në pasqyrat financiare.

Për arkëtimin e gjobave nuk është zbatuar marrëveshja me marrëveshjen e bashkëpunimi nr. 782 prot, datë 02.12.2010 me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nr. 15290/4 prot. datë 01.12.2010 dhe ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2011.

Nuk është zbatuar edhe Ligji nr. 10279, date 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative” neni 46, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 40-42 të Projekraportit të Auditimit.

### ***1.4 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.***

Për përmirësimin e gjendjes, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 647/6, datë 04.03.2009 “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”, ka rekomanduar për zbatim 4 masë organizative. Për zbatimin e rekomandimit të lënë, institucioni me shkresën nr. 33/3, datë 07.04.2009, ka njoftuar KLSH-në, për masat e marra.

Nga auditimi rezultoi se, rekomandimi i lënë nuk është zbatuar, trajtuar në mënyrë të detajuar në aneksin C – Zbatimi i rekomandimeve të mëparshme, faqet 48 të Projektraportit të Auditimit.

## **ANEKSI A – MBULIMI I AUDITIMIT.**

### **1. Mbi kontrollin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit.**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Autoriteti i Mediave Audiovizive në veprimtarinë e sajë ka zbatuar ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 97/2013, datë 04.03.2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Sipas nenit 11 të ligjit burimet e financimit të KKRT-së janë: - Të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave, të ardhura nga pagesa vjetore të licencës, të ardhura nga përpunimi i kërkesave për licensim, të ardhurat nga taksat për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive të caktuara në ligjet fiskale, financimet nga buxhetit i shtetit dhe dhurimet.

Bazuar dhe në ligjin nr 9936, datë 26.06.2008

Me Vendimin nr. 68, datë 02.02.2011 ”Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2011”, Keshilli i Ministrave ka miratuar në limite fondin dhe strukturën e shpenzimeve për vitin 2011.

Fondi i shpenzimeve në total për vitin 2011 vlera 89,070 mijë lekë, kjo e detajuar: - Paga 49,000 mijë lekë, sigurime shoqërore 7,300 mijë lekë, shpenzime koherente e të tjera 20,760 mijë lekë dhe shpenzime për investime 12,010 mijë lekë.

Me Vendimin nr.813, datë 23.11.2011 ”Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2012”.

Fondi i shpenzimeve në total për vitin 2012 vlera 98.4 milion lekë mijë lekë e detajuar: - Paga, sigurime 55.6 milion lekë, honorare 2 milion, shpenzime koherente e të tjera 19 milion lekë, detyrime për vendime gjyqësore 20.5 milion dhe shpenzime për investime 1.3 milion lekë.

AMA nga të dhënat e lartpërmendur ka miratuar shpenzime për vendimet gjyqësore, dhe për vitin 2011 dhe 2012 ka likuajduar detyrimet e 11 punonjësve që ka larguar nga puna dhe që kanë fituar me Vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil e më pas atë Gjykatës së Apelit për shumë 14,629.828 lekë. Detyrimet sipas punonjësve po i trajtojmë si më poshtë:

1-Besnik Goxhaj me detyrë Drejtor Kabineti është liruar nga detyra me Urdhër të Kryetares nr.113, dt.09.11.2009 dhe është paguar për shumën neto 1,966,572 lekë me sekuestro ekzekutive në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.1009, dt.10.05.2011.

2-Anila Hajnaj me detyrë Këshilltar është liruar nga detyra me Urdhër të Kryetares nr.116, dt.10.11.2009 dhe është paguar për shumën neto 1,749,498 lekë me sekuestro ekzekutive në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.757, dt.06.04.2011.

3-Alfiora Bilbili me detyrë sekretare e n/kryetarit të AMA-s i është zgjidhur kontrata me Urdhër të Kryetares nr.24, dt.04.02.2010 dhe është paguar për shumën neto 638,880 lekë po me Urdhër të Kryetares nr.343, dt.14.11.2011 në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.1418, dt.16.06.2011.

4-Elona Kana me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të çështjeve Juridike është larguar nga shërbimi civil me Urdhër të Kryetares nr.223, dt.02.09.2010 dhe është paguar për shumën neto 2,256,097 lekë po me Urdhër të Kryetares nr.88, dt.04.05.2011 në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.50, dt.01.07.2010.

5-Gentiana Biku me detyrë Specialist e Sektorit të çështjeve Juridike është larguar nga shërbimi civil me Urdhër të Kryetares nr.333, dt.09.12.2010 dhe është paguar për shumën neto 1,180,505 lekë po me Urdhër të Kryetares nr.66, dt.12.03.2012 në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.2597, dt.01.12.2011.

6-Alfred Bej me detyrë Drejtor Kabineti është liruar nga detyra me Urdhër të Kryetares nr.282, dt.26.10.2010 dhe është paguar për shumën neto 1,995,656 lekë me sekuestro ekzekutive në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.299, dt.16.02.2012.

7-Gjergj Memo me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Informacionit dhe Reklamave është larguar nga shërbimi civil me Urdhër të Kryetares nr.228, dt.04.07.2011 dhe është paguar për shumën neto 695,881 lekë po me Urdhër të Kryetares nr.125, dt.13.06.2012 në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.8, dt.08.02.2012.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

8-Luljeta Mërkuri me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të çështjeve Juridike është larguar nga shërbimi civil me Urdhër të Kryetares nr.198, dt.01.04.2011 dhe është paguar për shumën neto 900,657 lekë po me Urdhër të Kryetares nr.126, dt.13.06.2012 në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.96, dt.18.10.2011.

9-Almida Kalaja me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Programeve është larguar me masë disiplinore të marrë nga eprori direkt për largim të përkohshëm me Urdhër të Kryetares nr.817/2, dt.02.12.2011 dhe është paguar për shumën neto 52,203 lekë po me Urdhër të Kryetares nr.123, dt.13.06.2012 në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.55, dt.15.05.2012.

10-Andrea Nathanaili me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Programeve në AMA është larguar nga shërbimi civil me Vendim të Kryetares nr.191, dt.09.05.2011 dhe është paguar pjesërisht për shumën neto 1,993,879 lekë po me Urdhër të Kryetares nr.126, dt.13.06.2013 në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.10, dt.09.02.2012.

11-Nexhmi Mezani me detyrë Përgjegjë i Sektorit të Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave në Drejtorinë Teknike është larguar nga shërbimi civil me Vendim të Kryetares nr.28, dt.09.02.2010 dhe është paguar pjesërisht për shumën neto 1,200,000 lekë me sekuestro ekzekutive në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.1325, dt.05.06.2013.

Për marrjen e vendimeve për largimet e punonjësve nga puna nuk janë respektuar procedurat sipas Ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 për “Statusi i Nënpunësit Civil” dhe nga likujtimi i shumës 14,629,828lekë, nënkupton se janë paguar dy punonjës në një vënd pune..

## **2. Auditimi i llogarive të institucionit për vitin 2010, 2011 dhe 2012.**

Në Autoritetin e Mediave Audiovizive mbajtja e kontabilitetit për periudhën objekt auditimi, është bërë në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ndërsa, struktura, funksionimi dhe mbyllja e llogarive vjetore është bërë në bazë të vendimit të KM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qëndrore si dhe njërive që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998”.

AMA ka zbatuar Udhëzimi Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e llogarive vjetore të vitit 2006, për institucionet qëndrore, organet e pushtetit vendor dhe njërive të manaxhimit-zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, të ndryshuar, sipas Kapitullit I “Procedurat e raportimit të Pasqyrave Financiare”, janë depozituar llogaritë vjetore në organet përkatëse si më poshtë:

Për vitin 2011 Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Financave (Drejtorisë së kontabilitetit dhe Raportimit Financiar) me shkresën nr.436 prot., datë 29.03.2012, bilanci është shoqëruar me relacionin përkatës si dhe me analiza të debi kredive në detaje.

Për vitin 2012, pasqyrat financiare janë dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.742 prot, datë 28.03.2012, janë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi, bilanci është shoqëruar me relacionin përkatës si dhe me analiza të debi kredive në detaje.

Mbajtja e dekumentacionit dhe veprimet kontabile janë konform dispozitave ligjore, regjistrimet janë kryer sipas dokumentave justifikuese, bazuar në parimet e përgjithshme për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Sistemi i kontabilitetit mbahet me programin financa pesë, janë pasqyruar drejtë të gjitha veprimet kontabile, dhe janë regjistruar në ditarët përkatës si: Ditari i hyrjeve dhe daljeve të magazinës për lëvizjen e mallrave ,veprimeve me bankën,veprimeve me arkën, veprimeve për pagat, dhe veprimeve të ndryshme.

Gjatë auditimit me zgjedhje dekumentacionin e depozituar sipas periudhave në këtë institucion rezulton se, është zbatuar ligjshmëria dhe rregullshmëria financiare, duke vlerësuar saktësimin për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

plotsimin e pasqyrave të bilancit po i referohemi treguesëve në “Aktiv ” për vitin 2011 dhe 2012, ndryshimet e tyre, paraqiten si më poshtë poshte:

*në lekë*

	AKTIVI	2012 Ushtrimi mbyllur	2011 Ushtrimi mbyllur	Ushtrimi parardhes
<b>A</b>	<b>AKTIVETE QENDRUESHME</b>	<b>33,613,716</b>	<b>48,341,628</b>	<b>46,434,662</b>
	I. Të pa trupëzuara	90,000	90,000	85,500
202	Studime dhe kërkime	90,000	90,000	90,000
209	Amortizimi i Aqpt (-)	0,00	0,00	(4,500)
	<b>II.Akt.Qëndr.të Trup.</b>	35,523,716	48,251,628	46,349,168
214	Istal.tek,mak,paisje,vegla	11,829,828	11,829,828	11,825,818
215	Mjete transporti	10,243,314	13,003,314	15,852,814
218	Inventar ekonomik	92,969,779	92,644,159	93,598,870
219	Amortizimi AQT (-)	(82,989,304)	(70,695,772)	(76,398,870)
232	Shpenzime proces trasf. kap	1,470,099	1,470,099	1,470,099
<b>B</b>	<b>AKTIVE QARKULLUESE</b>	<b>183,909,765</b>	<b>153,306,427</b>	<b>113,152,655</b>
	I.Gjendja e Inventarit	1,954,888	1,258,795	1,669,278
	<b>II.Kerkesaark.mbi Debit.</b>	161,574,287	115,696,138	57,414,474
411-418	Klent llog.të ngjashme	114,977,079	87,097,431	35,004,108
431	Të drejta, taksa derdh.shtet	17,398,099	12,137,839	7,980,410
423-429	Personeli paredh.gjoba	45,360	0,00	0,00
	<b>III.Llogarite financiare</b>	30,380,590	36,351,494	54,068,903
512	Llogari në bankë	20,065,590	35,797,206	53,855,890
520	Disponibilitet thesar	162,271	332,524	357
531	Llogari në arkë	153,289	221,764	212,656
<b>C</b>	<b>Llogari tjera aktive</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
	<b>TOTALI I AKTIVIT</b>	<b>217,523,481</b>	<b>201,523,055</b>	<b>159,587,055</b>

*Burimi: Drejtoria ekonomike*

**Llogaria 202.** Aktive të patrupëzuara vlera 90,000 lekë është një studim dhe projektim e mbartur në vite.

**Llogaria 214.** *Istalime teknike, makineri,paisje,vegla pune* nuk ka ndryshime gjate periudhës së auditimit.

**Llogaria 215.** *Mjete Transporti* në vitin 2011 ka blerje dy mjete në vlerën 4,917,600 lekë, dhe shitje tre mjete në vlerën 7,767,100 lekë, në vitin 2012 shitje një mjet në vlerën 2,700,000 lekë.

**Llogaria 218.** *Inventari ekonomik*, i rregjistruara në pasqyrat financiare, referuar gjendjes në fillim të periudhës, ndryshimet dhe gjendja në mbyllje të ushtrimit në vlerën bruto, nuk ka ndryshime të theksuara gjatë viteve.

**Llogaria 219.** *Amortizimi i AQT (-)*, amortizimi është llogaritur sipas dizpozitave ne fuqi si, për gjendjet në fillim të periudhës edhe shtesat e krijuara.

**Aktivitet qarkulluese.**





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

**Kërkesë arkëtimi për debitorët, llogaria 411-418 klient e llog. të ngjashme**, duke e krahasuar vitin 2010 me 2011 paraqitet me një rritje në vlerën 52,093,323 lekë dhe viti 2012 me vitin 2011 paraqitet me një rritje në vlerën 30,603,338 lekë, kjo rritje ka ardhur si rezultat i mos arkëtimeve të detyrimeve branda periudhës nga operatorët privat radioteleviziv.

Detyrimi i subjekteve privat në fund të periudhës kanë pësuar rritje dhe arrin vlerën 114,970,079 lekë po kështu edhe llog.431 “ *taksa dhe derdhje në shtet*” e analizuar si më poshtë:

*Në milion lekë*

Nr.	Emërtimi i subjektit	Detyrim	Detyrim
		total	total
		pagesa	tax
<b>1</b>	Radio	4,962.6	1,531.8
<b>2</b>	Televizione	35,665.9	15,866.3
<b>3</b>	Kabllorë	53,348.0	0.0
<b>4</b>	TV Platforma Numerike	21,000.5	0.0
	<b>TOTALI</b>	<b>114,977.0</b>	<b>17,398.1</b>

Nga të dhënat e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme nga institucionit në vjeljen e detyrimeve ligjore .

**Llogaria 512 “banka”** Gjendja në bankë ne fund të vitit 2012 është në vlerën 20,065,590 lekë nga 53,855,890 lekë, ulja e gjendjes në bankë vjen nga rritja e detyrimeve vjetore dhe pakësimi i të ardhurave.

Nga auditimi i pasqyrës “**Pasivi**” për vitin 2010, 2011 dhe 2012, Fondet e veta bazë të paraqitur në pasqyrë, lëvizjet gjendja në fillim debi, kredi dhe gjendja në fund të periudhës janë rregjistruar e pasqyruar drejt, (*klasa B.detyrime nuk ka të dhëna*)

ndryshimet e treguesëve gjatë periudhave financiare paraqiten si më poshtë:

*Në lekë*

	PASIVI	2012 Usht. i mbyllur	2011 Usht. i mbyllur	Usht.parardhes
<b>A</b>	<b>FONDE TE VETA</b>	<b>217,523,481</b>	<b>201,648,055</b>	<b>159,587,323</b>
	I. Fonde te veta baze	217,523,481	201,648,055	159,587,323
<b>B</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>TOTALI PASIV</b>	<b>217,523,481</b>	<b>201,648,055</b>	<b>159,587,323</b>

Në pasiv në grupin B nuk janë pasqyrtuar detyrimi që ka AMA ndaj tatim taksave në fund të periudhës.

**Për vitin 2011**, arkëtuar nga subjektet taksa 16,081,620 lekë, derdhur për llogari të tatim taksave vlera 15,258,049 lekë diferenca mbetur gjendje 31.12.2011 vlera 823,571 lekë, kjo duhej pasqyruar në llogarinë 432, likuidimi është bërë në vitin pasardhës.

**Për vitin 2012**, arkëtuar nga subjektet taksa 12,284,111 lekë, derdhur për llogari të tatim taksave vlera 10,398,911 lekë diferenca mbetur gjendje 31.12.2011 vlera 1,885,200 lekë, kjo duhej pasqyruar në llogarinë 432, likuidimi është bërë në vitin pasardhës.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

### ***Pasqyrat financiare të operatorëve radiotelevizivë (RTV) viti 2011***

Në zbatim të nenit nr. 48 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, si dhe të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, operatorët radiotelevizivë janë të detyruar të hartojnë bilancet e tyre vjetore. Me shkresat përkatëse AMA(KKRT) ka kërkuar nga operatorët radiotelevizivë të cilët kanë patur aktivitete për vitin 2011, dhe 2012 të depozitojnë një kopje të pasqyrave financiare vjetore, të hartuara në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe të konfirmuara me numrin dhe datën e dërgesës postare.

Në mbyllje të vitit 2011, nga 220 operatorë të cilët kanë pasur aktivitete, 128 prej tyre kanë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit ose 59 % e operatorëve. Nga këta, kanë depozituar pasqyrat financiare 40 operatorë radio, 49 operatorë TV, 36 operatorë TV me kabëll dhe të 1 operator televiziv numerik. Situata financiare e operatorëve që kanë dorëzuar pasqyrat financiare rezultoi 23 me humbje ose 18 % , 13 operatorë ose 10 % ka rezultat financiar zero, ndërsa 92 janë me rezultat financiar pozitiv.

Në total rezultati ekonomik nga pasqyrat financiare të dorëzuara, në mbyllje të vitit 2011 janë në shumën **263 milionë** lekë.

### ***Pasqyrat financiare të operatorëve radiotelevizivë viti 2012***

Në mbyllje të vitit 2012, nga 250 operatorë të cilët kanë pasur aktivitete gjatë vitit, 103 prej tyre kanë dorëzuar pasqyrat financiare ose 41 % e operatorëve. Nga këta, kanë depozituar pasqyrat financiare 34 operatorë radio, 35 operatorë TV, 33 operatorë TV me kabëll dhe 1 operator televiziv numerik. Situata financiare e operatorëve që kanë dorëzuar pasqyrat financiare rezultoi 14 me humbje ose 14 % , 6 operatorë ose 5 % ka rezultat financiar zero, ndërsa 83 janë me rezultat financiar pozitiv.

Të ardhurat gjithsej të rezultuara nga pasqyrat financiare të dorëzuara, në mbyllje të vitit 2012 janë në shumën **675 milion** lekë.

Për ecurinë e dorëzimit të Pasqyrave financiare në vite, po paraqesim tabelën krahasuese e cila rezultoi si më poshtë:

nr.	Emërtimi	Viti 2011		Viti 2012	
		Nr. subjekteve	% ndaj totalit	Nr. subjekteve	% ndaj totalit
1	Operatorë gjithsej:	220		250	
	Oper. që kanë dorëzuar bilance	128	59	103	41
	Nga këta:				
	- me rezultat financiar fitim	92	72	83	81
	- me rezultat financiar humbje	23	18	14	14
	- me rezultat financiar 0	13	10	6	5

Nga të dhënat e mësipërme rezultoi se numëri i operatorëve është rritur, kurse dorëzimi i bilanceve tek AMA është ulur, po kështu edhe me rezultat financiar pozitiv është ulur nga 92 subjekte në 83, për këto shqetësime duhet njoftuar Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Nga operatorët kombëtarë kanë depozituar bilance kontabël për vitin 2011 dy operatorë, “Top Channel” privat dhe televizioni publik RTSH, gjithashtu, kanë dorëzuar bilancet vjetore dhe operatori numerik “DIGITALB” si dhe operatorët satelitorë “VIZION +” dhe operatori Televizioni “AS”. Nuk ka dorëzuar bilancin operatori privat kombëtar “Tv KLAN”. Për depozitim e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

pasqyrave financiare përveç shkresave që ju dërgohen nga ana e AMA-s, në rregulloret “Për rilicencimin e operatorëve publik dhe privat”, një nga kërkesat për rinovimin e licencës është dhe paraqitja e pasqyrave financiare. Mungesa e tyre përbën një kushtë për mos rinovimin e tyre. Nga përpunimi i të dhënave, vihet re se 28% e operatorëve rezoltojnë me bilancë negativë, dhe pjesa tjetër ka një fitim minimal. Për vitin 2012 operatoti televizionit kombëtar privat “Top Channel”, operatori Radio FM private kombëtare “Radio +2” dhe “Top Albania Radio”, operator radioteleviziv privat vendor, Radio “Scan”, Radio “AS”, si dhe Televizioni “Scan”, Televizioni “AS” dhe Televizioni “A 1”, kanë rezultuar me humbje.

### 3. Auditimi i zonave të llogarisë.

#### 3.1 Paga, shpërblime e të tjera personeli llog (600) dhe sigurimet shoqërore llog (601)

##### 3.1.1. Zbatimi i dispozitave ligjore për mardhëniet e punës dhe pagave.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, si institucion i pavarur, vepron në mbështetje të Ligjit Nr. 8410, datë 23.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 11, neni 12 dhe të akteve të tjera normative në fushën e ekonomisë dhe të financave.

Struktura e institucionit propozohet nga KKRT dhe miratohet nga Kuvendi (Ligji nr 9584, datë 17.07.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj").

KKRT e ndryshuar AMA, zbaton strukturën e saj në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.184, datë 19.05.2008 "Për zbatimin e strukturës organike dhe kategorizim të punës të Kshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit".

Për periudhën objektauditimi KKRT e ndryshuar AMA, ka funksionuar bazuar në strukturën organike të miratuar nga Kuvendi. Niveli i pagave është sipas VKM -së për nivelin e pagave të nenpunësit civil. Si dhe punonjësit mbështetës janë paguar në mbështetje të vendimit nr 184 të Kuvendit si dhe në zbatim të Lidhjes 1, të vendimit nr. 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar, sipas klasës përkatëse.

Në bazë të strukturës aktuale, numri i përgjithshëm i punonjësve është 49 (duzetëenëntë), ndërkohë që AMA(KKRT-ja) përbëhet nga 5 (pesë) Drejtori.

- Kryetari i AMA-s,
- Zv/Kryetari i AMA-s
- Drejtor Kabineti
- Këshilltar i Kryetarit të AMA-s
- Sekretare e Kryetarit dhe Zv/Kryetarit

Për vitin e audituar 2011-30.09.2013, rezulton se burimi i vetëm i financimit të institucionit janë të ardhurat e veta, të përdorura sipas limiteve të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 24.03.2010 "Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2011-2013".

Numëri i punonjësve të miratuar sipas strukturës organike për vitin 2011, 2012 dhe 9- mujorin e vitit 2013 e krahasuar me faktin paraqitet si më poshtë:

Tabela e paraqitur për vitin 2011-30.09.2013

Nr.	Emërtimi	Viti 2011			Viti 2012			9-mujori i Vitit 2013		
		Plan	Fakt	Nd +/-	Plan	Fakt	Nd +/-	Plan	Fakt	Nd +/-
1	<b>Punonjës gjithsej</b>	<b>49</b>	<b>48</b>	<b>- 1</b>	<b>49</b>	<b>48</b>	<b>- 1</b>	<b>49</b>	<b>48</b>	<b>- 1</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nga të cilët:										
- Ligjvënës, drejtues	9	9	0	9	9	0	9	9	0	
- Specialistë	29	28	- 1	29	28	- 1	29	29	0	
- Teknikë	2	2	0	2	2	0	2	2	0	
- Nëpunës të thjeshtë,	9	9	0	9	9	0	9	8	- 1	

Nga auditimi rezultoi se, AMA ka respektuar numrin e punonjësve dhe organikën e miratuar, për vitin 2011 dhe 2012 ka patur më pak një specialistë, ndërsa për vitin 2013 një punonjës mbështetës më pakë.

Vjetërsia në punë kryhet çdo muaj për të gjithë punonjësit dhe është pjesë e pagës bazë mujore, mbi të cilën zbatohen të gjitha detyrimet ligjore.

Nga krahasimi i organikës me listë pagesat e punonjësve nuk ka tejkalime.

### 3.1.2 Realizimi i fondit të pagave dhe krahasimi me vitet e mëparshme

Nga verifikimi I fondit të pagave për vitet 2011, 2012 dhe periudhën 9- mujore të vitit 2013, si dhe nga analiza e mësipërme, paraqesim tabelën krahasuese e cila rezulton si më poshtë:

*Në milionë lekë*

Nr.	Emërtimi	Viti 2011			Viti 2012			9- mujori i Vitit 2013		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Fondi i pagave	49	45,2	92	48,6	44,6	92	51	33	65
2	Sig. Shoq.	7,3	6,3	87	7	6,2	89	7,5	4,9	65

Nga të dhënat e mësipërme rezulton e realizimi i fondit të pagave për vitet 2011,2012 dhe 2013 është mesatarishtë 92 %, dhe sigurimet shoqërore mesatarishte në 90 %. Mosrealizimi ka ardhur si rezultat i mungesës pjesore të organikës, dhe për paafhtësinë e përkohëshme të disa punonjësve për një kohë relativishtë të gjatë.

Nga auditimi në tërësi të listë pagesave për periudhën e përcaktuar në program, rezultoi se shuma e përgjithëshme e listë pagesave është e njëjtë me urdhër xhirimin e përgatitur për këtë qëllim. Përmbledhëset e listë pasës në çdo rast janë të nënshkruara nga Kryetari i AMA-s (KKRT), Drejtori Ekonomik si dhe Specialisti i Financës. Listë pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat sipas Drejtorive, të cilat janë të firmosura në çdo rast nga Drejtori përkatës dhe Drejtori i Burimeve Njerëzore si dhe miratuar nga Titullarja e Institucionit.

Libri i pagave për periudhën objekt kontrolli është plotësuar me të gjithë punonjësit në marrëdhënie pune, ku shënohen të hedhura për cdo muaj të gjitha ekstraktet sipas listë pagesës nga paga bruto, shtesat, ndalesat deri në pagën neto, libri I pagave për vitin 2013 ishte I azhornuar deri në muajin shtator 2013.

Thekësojmë se, vit mbas viti në Autoritetin e Mediave Audiovizive, vihet re një disiplinim i pagesës për orë mbi kohën normale të punës, duke filluar nga 674.833 lekë të paguar në vitin 2011, 334.361 lekë të paguar në vitin 2012 si dhe 62.374 lekë, për 9-mujorin e vitit 2013.

### 3.1.3 Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënia e shpërblimeve, ndihma për fatëkeqësi, për nevoja kulturore etj.

Nga auditimi, konstatohet se fondi i shpërblimeve është krijuar sipas Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010, i ndryshuar, krijohet Fondi i veçantë në masën 5 % të fondit të planifikuar për pagat për vitin 2011, 2012, si dhe për 9- mujorin e vitit 2013.

Fondi i vecantë është llogaritur dhe planifikuar si më poshtë :

*Në milionë lekë*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr.	Emërtimi	Viti 2011			Viti 2012			10 mujori i Vitit 2013		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Fondi i veçantë	2,3	1,9	83	2,3	1,9	83	2,4	0	0
2	Shp. për rezultate në punë		1,3			1,35		0	0	0
3	Shp. për fund viti		0,48			0,46			0	0
4	Shp. sëmundje		0,05			0			0	0
5	Për aktivitete soc-kult.		0,13			0			0	0
6	Për raste fatekeqësie		0			0,09			0	0

Fondi i vecantë është përdorur për shpërblim punonjësve në fund vitit në masën 10.000 lekë si dhe në fund të viti 2012, për 32 punonjës e cila është paraqitur dhe ne proces verbal nr 4 , Fondi i shpërblimeve është nga të ardhurat e vetë institucionit.

### **3.1.3 Respektimi i dispozitave ligjore për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale.**

Nga auditimi në tëresi të listë pagesave për periudhën e përcaktuar në program, u konstatua se llogaritja e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi pagat dhe të ardhurat personale, është bërë në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjt nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetsore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Llogaritjet janë bërë për çdo punonës, janë ndaluar nga paga sigurimet shoqërore e shëndetësore, duke respektuar kufirin minimal e maksimal, tatimi mbi pagën, dhe njëkohësisht janë xhiruar në institucionet përkatëse, të rakorduara me listat përkatëse.

Gjatë auditimit të pagave u kostatua se raportet mjekësore nuk janë tatuar sipas ligjit të sigurimeve shoqërore proces-verbal i mbajtur si me poshtë:Për periudhën , Janar 2011-30.09.2013 ,rezultosi se: Në asnjë rast nuk janë tatuar raportet mjeksore , për pagesat që bën institucioni deri ne 14 ditë kjo në kundërshtimi të ligjit Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993“Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërise” të ndryshuar,pika b) e nenit 8/ të ligjit nr . 8483,datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat “I ndryshuar sipas të cilit të ardhurat qe I merr I punësuari për 14 dite e para me raport mjekësor,nuk janë të përjashtuara për qellim të tatimit mbi të ardhurat personale ,pra si të tilla ato janë të ardhura të tatueshme .

***Punonjesit qe janë paguar me raportet mjeksore për periudhen Janar 2011-30.09.2013 gjithsej 24 punonjës me vlerë 1.306.834 lekë x 10% = 130.683 lekë.***

Nr	Emer	Mbiemer	Shuma gjithsej	Ndalesat
1	Jonida	Ukcanaj	19.320	1.932
2	Almida	Kalaja	406.572	40.657
3	Elda	Shkullaku	94.405	9.441
4	Zimo	Kurti	53.867	5.387
5	Manjola	Thanasi	90.194	9.019
6	Igbana	Caçi	53.610	5.361
7	Blerina	Osmani	26.078	2.608
8	Shkelqim	Bylyku	3.483	348
9	Endrit	Cami	26.435	2.644
10	Eglantina	Harroku	23.190	2.319



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

11	Edra	Dedja	52.040	5.204
12	Shejnaze	Mane	19.748	1.975
13	Endrit	Kopliku	10.839	1.084
14	Valentina	Vrangu	19.268	1.927
15	Sevada	Gu ç i	17.907	1.791
16	Ada	Hysi	29.298	2.930
17	Erjona	Fishta	39.337	3.934
18	Erjon	Jashari	92.204	9.220
19	Pirro	Koçi	94.930	9.493
20	Fatbardh	Zenelaj	7.696	770
21	Lindita	Kikno	5.184	518
22	Tonin	Prenga	9.994	999
23	Olta	Staza	5.513	551
24	Teuta	Bakalli	105.772	10.572
	<b>Totali</b>		<b>1.306.834</b>	<b>130.683</b>

### 3.2 Mallra dhe shërbime (llog.602)

3.2.1. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë.

Për periudhen e audituar për veprimet e arkës në vlerë dhe valutë në KKR e ndryshuar (AMA), rezultoi se ishte respektuara baza ligjore, sipas nenit 42 të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", i shfuqizuar, si dhe në zbatim të nentit 32, kreu V, "Format, rregullat, afatet per pagesat me anë të bankës dhe arkës" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 70, datë 11.03.1985 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", i shfuqizuar, si dhe në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për manaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public", pranë autoritetit të Mediave Audiovizive, mbahen veprimet me arkën në lekë dhe në valutë.

Nga auditimi i dokumentave të arkës për periudhen Janar 2011-30. 09.2013, veprimet si në lekë ashtu edhe në valutë, rezultoi se, të gjitha veprimet, arkëtimet dhe pagesat, janë të prerë respektivishtë mandat arkëtimi ose mandat pagesa, dhe të firmosuar nga personat përgjegjës, të justifikuar me dokumentat përkatëse. Sipas dokumentave të sipërcituara janë bërë rregjistrimet në librin e arkës. Në fund të cdo muaji është bërë gjendja e arkës .

Ne veprimet me arkën në lekë, arkëtimet kryesishtë vinë nga pagesat për marrje dokumentacioni për aplikim për marrje ose rinovim licence, pagesa për paëpunim dokumentacioni, pagesa për shërbime të ndryshme nga AMA, si fotokopje dokumentacion, tarifën e shërbimit të kryer nga studio e Monitorimit, sipas vendimi të AMA-s (KKRT-së) nr. 71, datë 18.12.2001, etj.

Nga arka janë kryer pagesat për blerje të vogla, për riparime të ndryshme emergjente, dieta shërbimi, pagesa të pullave pranë gjykatave.

Më poshtë paraqitën, mandat arkëtime dhe mandate pagesat për periudhën Janar 2011-30.09.2013, janë si më poshtë:

Gjatë vitit 2011 janë prerë gjithsej 106 mandat arkëtime ,dhe 193 pagesa ,ku ne te shumtat e rasteve jane për blerje më vlera te vogla poshtë vlerës 15.000,lekë,që është e percaktuar por në 3-4 raste është kaluar limiti i arkës ,ku më këto raste duhet te beheshin likujdimet me xhirim banke.

Në fundë të vitit 2011 gjendja në arkë në lekë 31.667 lekë .Në vitin 2012 janë prerë gjithsej 74, arkëtime dhe 233, mandat pagesa , dhe kanë bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e duhur



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

justifikues. Gjendja në fund të vitit 2012 është në vlerë 570 lekë.

Për 9-mujorin e vitit 2013, janë prerë 55 mandat arkëtime dhe 185 mandat pagesa .

Gjatë auditimit të veprimeve të arkës në lekë u bë dhe proces –verbali , në të cilin nuk rezultuan diferenca në gjendjen e arkës, pra gjendja fizike ishte e barabartë me gjendjen kontabile .

Gjendja e arkës në fund të vitit 2011 ishte 31.667 leke

Gjendja e arkës në fund të vitit 2012 ishte 570. leke

Gjendja e arkës në 30.09.2013 rezultoi në vlerë 321.247 lekë

Për periudhën objekt auditimi kryer për arken në valutë për periudhën Janar 2011-30.09.2013, dokumentacioni ishte i rregullt , ishte respektuar baza ligjore në fuqi për përdorimin e valutës .

Nga arka janë kryer pagesa për paradhënie punonjësve të cilët janë dërguar me dhe llogaritja e dietave janë bërë konform Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 08.05.2003, i shfuqizuar, me Vendimin e KM nr. 870, datë 14.12.2011. *Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit.* shërbim si dhe mbyllje e kësaj paradhënie.

Gjatë vitit 2011 ishin prerë gjithsej 45 mandat arkëtime dhe 51 mandat pagese , dhe gjendja në fund të vitit 2011 ishte 1.580 euro .

Në vitin 2012 janë prerë gjithsej 28 mandat arkëtime dhe 42 mandat pagesa dhe vlera në fund të vitit 2012 është në vlerën 1.305 euro .

Për 9-mujorin e vitit 2013 janë prerë gjithsej 22 mandat arkëtime dhe 29 mandat pagesa dhe gjendja në fund të 9-mujorit rezulton 953 euro .

Nga auditimi u konstatua se në çdo fund të vitit arka është me gjendje si në lekë ashtu dhe në valutë , që përben shkelje , *”për administrimin dhe ruajtjen e vlerave monetare”*

### **3.2.2 Gjendja e mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm.**

Nga kontrolli i dokumentacionit të magazinës për periudhën objekt auditimi 2011 deri 30.09.2013, rezulton se:

Dokumentacioni i fletë hyrjeve dhe daljeve të mallrave dhe të materialeve në magazinë është plotësuar në të gjitha rastet, me urdhërat e dorëzimit, plan shpërndarje apo me kërkesa të sektorëve përkatës që do fuznizohen nga magazina.

#### ***Inventarizimi i pronës shtetërore .***

Për vitin 2011-2012 , ky institucion ka kryer inventarizimin e pasurisë së institucionit në bazë të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 Për Radion e Televizionin Publike Privat në Republikën Shqiptarë *”Për administrimin ruajtjen dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”* dhe VKM nr.70, datë 11.03.1985, me ndryshime, si dhe me ligjin nr. 10269, datë 08.07.2011 *”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30 date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”*. Inventarizimi i pasurisë së institucionit është kryer në bazë të urdhërave të Titullarit të nxjerra për këtë qëllim. Të gjitha fletat e inventarit janë të plotësuara në sasi dhe në vlerë dhe të firmosura nga anëtarët e komisionit, dhe nuk rezultojnë diferenca fiziku me kontablin.

Në vitin 2011 është nxjerrë urdhëri nga titullari për inventarizimin e Aktiveve të Qëndrueshme në KKRT, në zbatim të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 *”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11.03.1985 *”Për administrimin ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale monetare”* dhe me urdhër nr. 266, datë 13.09.2011 janë ngritur komisionet e vlerësimit të vlerave materiale për nxjerrjet jashtë përdorimit, dhe urdhër nr. 285 datë 6.10.2011, është ngritur komisioni i asgjësimit të tyre., urdhërat kanë të bashkëlidhur relacionet dhe proces-verbalet.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Vlera e nxjerrjes jashtë përdorimit ne vitin 2011 është në vlerë **4.670.770 lekë**, praktikat bashkëlidhur ka urdhrin e titullarit, gjithashtu kanë të gjitha procesverbalet si dhe urdhrat nga punonjësit përgjegjës për nxjerrjen materialeve jashtë përdorimit.

Në vitit 2013, janë nxjerrë urdhërat nga Titullari i institucionit përkatësisht me nr .26 datë 27.02.2013, Për nxjerrjen jashtë përdorimi të materialeve të Institucionit,të bazuar ne Vendimin e Kshillit të Ministrave nr 70 adtë11.03.1985, “Për administrimin, ruajtjen e dokumentimin e qarkullimin e vlerave material dhe monetare, i ndryshuar, me udhezimin nr. 30, date 27.12.2011, “*Për menaxhimin e Aktiveve në sektorin publik*”. Të cilit nuk janë referuar ,bazës ligjore të saktë, pra vendimit nr.30 datë 27.11.2012, ‘*Për menaxhimin e aktiveve në njesiteë e sektorit publik*’ku theksohet që komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit duhet të jete jo me më pak se 5 antar pika 100- si dhe pika 101 –për asgjësimin duhet që komisionit të jëtë i përbërë jo me pak se 7 veta .

Vlera e nxjerrjeve jashtë perdorimit në vitin 2013 është **1.222.275 lekë**. Praktikrat janë të shoqëruara me proces-verbale si dhe me urdhrat nga punonjësit përgjegjës për nxjerrjen jashtë përdorimit ,por duke theksuar se nuk kanë zbatuar vendimin nr.30 datë 27.11.2012, ‘*Për menaxhimin e aktiveve në njesiteë e sektorit publik*’.

### **3.2.3 Ligjeshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera me bankën.**

Nga auaditimi me zgjedhje i dokumentacionit të bankës ,paraqitur nga sektori i financës për periudhën objekt auditimi, rezulton si më poshtë:

Kontabilizimi i veprimeve është bërë në përputhje me ligjin për kontabilitetin nr. 9228, datë 29.4.2004 .

Funksioni i urdhruetit ishte i ndarë nga funksioni regjistruetit të veprimeve në ditar. Lëvizja e parave nga bankat e ndryshme ishte e organizuar duke zbatuar rregullat financiare,dhe të gjitha veprimet ishin të kontabilizuara në ditarin e bankës .

Gjatë periudhës së auditimit për vitit 2011 - 30.09.2013, blerjet me vlera të vogla janë kryer në mbshtetje të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VI, pika 2 “Për blerjet me vlera të vogla”.

Ku në cdo fillim viti nga titullari i entit prokurues është nxjerre urdhëri për ngritjen e komisionit për “Blerjet me vlera te vogla “, i cili ka funksionuar gjate gjithë vitit ushtrimor.

Gjatë auditimit te veprimeve te kryera me bankë per vitin 2011 - 30.09.2013 u kontatuon disa shkelje dhe mangësi .

- Me xhirimin e bankës datë 15.02.2011, blerë materiale për pastrim me vlerë 132.400 leke, me përfitues Benjamin Shehaj me urdhër prokurimi nr. 6, datë 14.01.2011 nga titullari i institucionit praktika bashkëlidhur ne flete hyrje ka vetem firmen e pergjegjesit te administrates (pra magazinieri nuk ka firmosur për marrjen e mallit në dorzim ).

- Me xhirimin e bankës datë 25.02.2011 blerë Ram 2 gb me vlerë 5430 lekë me përfitues sintheza Co shpk praktika nuk ka bashkëlidhur fletë hyrje ne magazine .

- Me xhirimin e bankës me datë 24.03.2011, me urdhër prokurim është përshkruar sigurim i kaskës i pjeshëm ndër kohë që në fature tatimore është kryer sigurim i plotë ka dalë jashtë përshkrimit të urdhrin prokurimit dhe vlera është 73.440 lekë. Me përfitues linsig në *kundërshtim me ligjin e prokurimit për blerjet e vogla*.

- Me xhirimin e bankës datë 14.11.2011, është kryer shërbim për blerje të vogla, me urdhër prokurimin nr. 58 datë 11.11.2011 rikonstruksion i pjesshëm i godinës me përfitues TEA –D Shpk me vlerë 476.820 lekë , praktika bashkëlidhur nuk ka një proces-verbal ose aktkolaudimi për kryerjen e këtij shërbimi.

- Me xhirimin e bankës datë 06.10.2011 me urdhër prokurimin nr. 53 datë 03.10.2011 kryer





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

shërbime mjeti me përfitues Pellumb Xhaferraj me vlerë 29.900 praktika nuk ka bashkëlidhur fletë - hyrje në magazine për pjesët blera .

- Me xhirimin e bankës datë 02.05.2011 me urdhër prokurimin nr.28.04.2011, për servis të mjetit hynday me përfitues Pellumb Xhaferri me vlerë 36.500 lekë praktika nuk ka fletë –hyrje.

- Me xhirimin e bankës datë 16.09.2011 blerë telefon me urdhër prokurimin nr 46 datë 12.09.2011, për blerje aparat telefoni ,me vlere 70.000 lekë me përfitues Robert Haxhymerai ,praktika për likuidim nuk ka bashklidhur në formularin nr 3 ,të testimit të tregut tre operator ekonomik në kundërshtim me ” *vk m nr 1, datë 10.01.2007* “i ndryshuar.

Gjatë auditimit me zgjedhje të dokumentave te bankës për vitin 2012, në përgjithësi praktikat për likuidim ishin të rregullta duke përjashtuar në disa raste në të cilat janë u konstatuar disa shkelje dhe mangësi në plotësimin e dokumentacionit .

- Me xhirimin e bankës datë 25.04.2012 me urdhër prokurimi nr 29, datë 20.04.2012 është blerë telefon celular me vlerë 820 euro e konventuar ne 115.620 lekë, për kryetaren e institucionit me përfitues Migen Kasaj, në kundërshtim me rregullat e “Prokurimin me vlera të vogla “, ku theksohet që blerjet përdorën për nevoja te institucionit, formulari nr 3 nuk ka të përshkruar 3 ofertat ekonomike sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar , .

- Me xhirimin e bankës datë 17, 09.2012 blerë kondicioner me vlerë 50.000 lekë me përfitues Uni Klima shpk praktika bashkëlidhur për likuidim nuk ka në formularin tre, tre operator për të cilët është bërë testim tregu.

- Me xhirimin e bankës datë 19.09.2012 blere dy karta televizive me vlerë 12.200 lekë, me përfitues Alket Beqaraj, nuk është bërë hyrje në magazinë, formulari nr tre nuk ka tre ofertat e operatorëve ekonomik .

- Me xhirimin e bankës datë 27.09.2012 blerë karrige skrivani rrotulluese me vlerë 56.000 lekë me përfitues Dromeas Albania , praktika bashkëlidhur për likuidim nuk ka, në formularin nr tre, tre operator për te cilët është bërë testim tregut.

Nga auditimim i bankës vihet re se gjatë vitit 2012 në shumë raste nuk është plotësuar formulari nr tre ,me tre ofertat të operatorëve ekonomik sipas “*vendimit nr.1 date datë 9.03.2011, për blerjet e vogla* “.

Per periudhën e audituar për 9-mujorin e vitit 2013.

- Me xhirimin e bankës datë 21.01.2013 riparim fotokopje, me vlerë 30.700 lekë, me përfitues BNT Elektronik, me urdhër prokurimi nr.13, datë 14.01.2013, formulari nr.3 nuk ka tre operatorët ekonomik per testimin e tregut ,fatura tatimore nuk ka kuponin e kases fiskale ,

- Me xhirimin e bankës datë 31.01.2013 blerë aparat celular me vlerë 77.000 leke me përfitues Klementian Shatro, për kryetarin e KKRT –se ,fatura tatimore nuk ka kuponin e kasës fiskale dhe formulari nr. tre nuk ka tre operator ekonomik sipas testimit të tregut .

Në shumë raste për blerjet e kryera me xhirime nëpërmes bankës me urdhrat e prokurimit të nxjerrë nga titullari për kryerjen e blerjeve me vlera te vogla ,nuk plotësohet formulari nr, tre per testimin e tregut sipas *Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, indryshuar, kreu VI, pika 2. “Për blerjet me vlera të vogla”*.

Gjatë auditimit u konstatuan disa shkelje në lidhje me pagesat e bëra nga arka dhe banka , të cilat janë të paraqitura më poshtë.

**a-**Nga ana e nëpunësit autorizues dhe zbatues të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), për periudhën objekt auditimi Janar 2011 – 30 shtator 2013, janë autorizuar dhe kryer pagesat e punonjësve për punë mbi kohën normale të punës dhe ditët e pushimit javor, me nga 40 orë në muaj gjithashtu, janë dhënë shpërblime në fund të vitit 2012, për punonjësit e AMA-se .

**b.**Praktikat shoqëruese për pagesat e orëve jashtë orarit nga ana formale janë plotësuar në rregull, pasi ato përmbajnë të gjithë dokumentacionin shkresor, që kërkon ligji, dhe VKM Nr. 511, datë 24.10.2002 “*Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore*”, te ndryshuar, ku në pikën 5 nënvizohet shprehimisht se:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

*“Me kërkesë te eprorit te drejtpërdrejtë dhe me miratimin e drejtuesit te institucionit përkatës, nëpunësit civil apo punonjësit mund t'i kërkohej te kryeje ore shtesë....”.*

Nga ana e titullarit të AMA-se janë nxjerrë urdhrat përkatës për pagesat e punonjësve që kanë punuar jashtë orarit zyrtar .

Pagesat janë mbështetur në dokumente\acionin autorizues, në kërkesat e bëra sipas sektoreve përkatës mbi nevojën e përbalimit të këtyre punëve jashtë kohës normale dhe pagesat e orëve mbi kohën normale të punës gjate vitev 2011 e deri me datë 30.09.2013.

Nga ana e strukturave përgjegjëse në AMA është përdorur justifikimi për kryerjen e pagesave në të shumtat e rasteve me arsyetimin *“për monitorime të medias,për risistemim dosjesh te kuadrit ,për përgatitjen e materialeve për tu publikuarne ëbsite-in e institucionit, etj...”* .

Janë paguar orë mbi kohen normale për vitin 2011 -2012, referuarVendimit të Këshillit të Ministrave nr .511, datë 24.10.2002 *“Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” te ndryshuar* , me vendimi nr. 472 datë 2.07.2011, *“Per disiplinimin dhe përdorimin e fondeve “si më poshtë:*

### **a-Paguar ore pune mbi kohen normale gjatë vitit 2011:**

Janë realizuar pagesa për 23 punonjës me vlerë të përgjithshme pas tatimit në burim për 674.833 lekë. Në mënyrë të detajuar, efektet financiare të shpenzuara për çdo punonjës pasqyrohen në vijim.

Nr	Emer Mbiemer	Shuma
1	Dritan Gjyrezi	30,443
2	Enio Haxhimihali	58,367
3	Sotila Grabocka	25,509
4	Englantina Haroku	39,330
5	Edra Dedaj	47,340
6	Roland Cenaj	36,832
7	Raif Gorana	20,904
8	Jani Sotillari	3,988
9	Perparim Ademi	6,437
10	Olta Stasa	19,395
11	Fatbardh Zenelaj	7,275
12	Sevada Guçi	37,716
13	Sara Xhumbari	14,160
14	Griselda Metaliaj	47,340
15	Ada Hysi	27,924
16	Endrit Koplaku	32,876
17	Sami Neza	26,080
18	Erjona Fishta	23,213
19	Pirro Koçi	14,454
20	Tonin Prenga	12,297
21	Sheinaze Mane	40,692
22	Erisa Ymerli	61000
23	Fatri Seferi	41,261
	<b>Totali</b>	<b>674,833</b>

Burimi: Drejtoria ekonomike. AMA.

### **b-Paguar ore pune mbi kohen normale gjatë vitit 2012:**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nga auditimi vërehet se dhe në këtë vit janë nxjerrë urdhrat nga titullari për përballimin e punës që do kryhet mbi kohën normale të saj. Si referencë ka shërbyer Vendimii Keshillit Ministrave nr. 511 date 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar, me vendimi nr. 472 datë 2.07.2011, “Per disiplinimin dhe përdorimin e fondeve “. Jane paguar 17 punonjës me vlerë të përgjithshme pas zbritjes së tatimit në burim prej **344.361 lekë**.

Nr	Emër Mbiemër	Shuma
1	Edmond Kazanxhi	68,985
2	Ermal Cani	49,534
3	Jonida Ponari	7,902
4	Sara Xhumbari	14,196
5	Griselada Metaliaj	11,871
6	Pirro Koçi	14,904
7	Jani Sotillari	9,975
8	Raif Gorana	15,980
9	Ada Hysa	5,127
10	Arian Skenderi	7,428
11	Erisa Ymerli	3,779
12	Shejnaze Mane	3,083
13	Olta Stasa	21,926
14	Endrit Kopluku	32,422
15	Englantina Haroku	22,348
16	Ermal Cani	33,605
17	Engjellushe Ibrahim	21,296
	<b>Totali</b>	<b>344,,361</b>

Burimi: Drejtoria ekonomike. AMA.

### c. Paguar ore mbi kohën normale gjatë vitit 2013:

Orët shtesë për vitin 2013, janë të shoqëruara me urdhërat e titullarit, dhe janë vijuar pagesat, bazuar në Vendimine Keshillit Ministrave nr. 511, date 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” të ndryshuar, me vendimi nr. 472 datë 2.07.2011, “Per disiplinimin dhe përdorimin e fondeve “.

Gjatë vitit 2013 rezulton se, janë paguar 5 punonjës me vlerë të përgjithshme pas zbritjes së tatimit në burim prej **62.374 lekë**.

Nr	Emer Mbiemer	Shuma
1	Shkelqim Bylyku	28,498
2	Endrit Çami	28,498
3	Perparim Ademi	2,147
4	Lida Kikino	1,296
5	Erjon Jashari	1,935
	<b>Totali</b>	<b>62,374</b>

Burimi: Drejtoria ekonomike. AMA

Nga auditimi i veprimeve të bankës dhe të arkës për periudhën objekt auditimi (1.1.2011 deri me 30.09.2013), u konstatuan disa mangësi në pagesat e shërbimeve, ku në mjaftë raste,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

dokumtnacioni justifikues bazë (fletat e hotelit) ishin të shoqëruar me fature tatimore të thjeshtë, dhe ne disa raste me vërtetime hoteli dhe në asnjë rast nuk kanë bashkëlidhur kuponin e kasës fiskale. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e pikës nr. 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës "ku përcaktohet shprehimisht se "shpenzimet e fjetjes të paraqitura nga hoteli të jenë të shoqëruara me fature të printuar nga kasa elektronike fiskale".

Konkretisht, janë vërejtur këto raste të pagesave në kundërshtim me përmbushjen e detyrimeve të VKM së sipërcituar: Gjatë periudhës së auditimit janë paguar 14 punonjës me vlerë **232.000** lekë.

Nr	Emer	Mbiemer	Shuma
1	Erjon	Jasahri	9,000
2	Raif	Gorana	4,000
3	Tonin	Prenga	4,000
4	Pirro	Koçi	6,000
5	Jani	Sotillari	3,000
6	Entjen	Hanxhari	3,000
7	Perparim	Ademi	13,000
8	Ada	Hysi	15,000
9	Sara	Xhumbari	3,000
10	Dritan	Gazidede	3,000
11	Pirro	Braçe	3,000
12	Almida	Kalaja	3,000
13	Dritan	Gazidede	6,000
14	Sara	Xhumbari	15,000
	<b>Totali</b>		<b>232,000</b>

Burimi: Drejtoria ekonomike. AMA

### d-Paguar shpërblime ne fundë të vitit 2012.

Me xhirimin e bankës datë,28.12.2012 janë paguar shpërblime në fund të vitit 2012 për punonjësit që paguhen me "status te të nëpunësit civil" KKRT-se me 70% të pagës mujore me urdhër Titullari nr. 275 datë 11.12.2012, referuar në "Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010" i ndryshuar. Janë paguar 32 punonjës me vlerë **1.203.195** lekë.

Nr	Emer	Mbiemer	Paga
1	Raif	Gorana	42,094
2	Fatri	Seferi	28,494
3	Sara	Xhumbari	24,011
4	Valentina	Vrangu	19,611
5	Teuta	Bakiri	43,142
6	Manjola	Thansi	40,748
7	Jonida	Uçaj	30,703
8	Tatbardh	Zenelaj	64,170
9	Tonin	Cobani	66,060
10	Tonin	Prenga	53,249
11	Xeni	Karaj	61,686
12	Entjen	Haxhinari	39,047



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

13	Endrit	Cami	31,109
14	Erjon	Jashari	31,109
15	Nevila	Dyrmishi	54,004
16	Sotilda	Grabocka	30,893
17	Lida	Kokino	25,209
18	Jani	Sotillari	10,794
19	Përparim	Ademi	9,051
20	Shkelqim	Bylyku	31,108
21	Teuta	Bakalli	42,367
22	Zimo	Krutaj	42,637
23	Blerina	Osmani	30,730
24	Igbana	Caco	30,730
25	Arian	Skenderi	16,249
26	Sami	Nezaj	44.008
27	Endira	Bushati	76.078
28	Dritan	Gjyrezi	39.181
29	Enio	Haxhimihali	48.661
30	Elda	Shkullaku	40.558
31	Erjon	Fishta	22.620
32	Jetmir	Olldashi	31.298
	<b>Totali</b>		<b>1.203.195</b>

### 3.2.4 Analiza e shpenzimeve për mjetet e transportit.

Për periudhën objekt kontrolli ky institucion ka patur në inventar, 5 automjete me vlerë 10,527,100 lekë që janë shitur me ankand, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1139, datë 24.11.2009 “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të Ministrive dhe institucionet qëndrore”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1242, datë 16.12.2009 “Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxirret në ankand, si dhe për mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor” si dhe urdhërit të Kryeministrit nr. 22, datë 26.01.2010 “Për evidentimin e automjeteve të tepërta në dispozicion të ministrive dhe institucioneve vartëse”. Aktualisht institucioni ka 3 automjete (tip Land Cruise dhe tip jeta skoda) ku dy të fundit janë blerë me tenderim sipas dokumentacionit përkatës dy nga të cilat me vlerë në kontabilitet në shumën 4,917,600 lekë. Makinat u shiten sipas dokumentacionit përkatës:

Mjeti Marka Hyundai Accent, me targë TR5941E, në vlerën totale 78,000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë me TVSH. Kontrata me nr. rep. 2382 nr.514 kol. me datë 07.09.2011. Mënyra e pageses me arke nr. 93/1, datë 07.09.2011. Për mjetin Marka Hyundai Galloper me targë TR2518L, në vlerën totale 135,000 (njëqindtridhjetepesëmijë ) lekë me TVSH. Kontrata me nr. rep. 2380 nr.512 ko.l me datë 07.09.2011. Mënyra e pagesës me bankë (Credins Bank) datë 07.09.2011. Për mjetin Marka Volksäagen Bora, me targë TR1216H, në vlerën 105,000 (njëqindpesëmijë) lekë me TVSH. Kontrata me nr.rep 2379 nr.511 kol. datë 07.09.2011. Mënyra e pagesës me bankë datë 07.09.2011. Për mjetin marka Hyundai Lantra, me targë TR9580E, në vlerën 76.000 (shtatëdhjetëegjashëmijë) lekë me TVSH Kontrata me nr.rep 2381 nr.513 kol me datë 07.09.2011. Mënyra e pageses me bankë datë 07.09.2011. Për mjetin marka Toyota Avensis, me targë TR 3039P, në vlerën 465,000 (katërqindegjashëtëdhjetepesëmijë)lekë me TVSH Kontrata me nr.rep 1806 nr.817 kol. me datë 21.08.2012. Mënyra e pageses me arkë datë 17.09.2012.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Titullari i institucionit, për disiplinimin e shpenzimeve të transportit nuk ka nxjerrë urdhër të Brendshëm për administrimin dhe përdorimin e karburantit dhe të përcaktojë komisionin për matjen e harxhimit të karburantit për çdo 100 km për këto 5 mjete të institucionit.

Përgjegjësi i sektorit të administratës, në bazë të fletë udhëtimeve ka mbajtur procesverbale për çdo muaj dhe ka llogaritur harxhimit e konsumimit të karburantit për 100 km për autoveturat e AMA-s.

U kontrolluan dokumentacioni që mbante sektori i administratës dhe rezultoi se çdo përdorues mjeti, plotësonte fletë udhëtimi të firmosura nga personat që kryenin udhëtimin dhe nga përgjegjësi i këtij sektori. Gjithashtu për çdo mjet nuk kishte kartela të veçanta për harxhimin e karburantit dhe shpenzimet e riparimit të tyre, të cilat të korespondonin me sasinë e karburantit të bërë dalje nga magazina.

Në këtë institucion sipas urdhërave të Kryetares së AMA-s nr. 7, dt.13.01.2011, nr. 193, dt.12.05.2011, nr. 1, dt.04.01.2012, nr. 152, dt.09.07.2012 si dhe urdhërat për 9/mujorin e vitit 2013 që grupet e inspektimit të dalin për inspektim janë harxhuar karburant dhe janë bërë riparime për 6 autovetura në përdorim, si më poshtë për periudhën objekt kontrolli:

Nr	Vitet	Riparime në lekë	Karburanti i harxhuar				Diferencë në lekë
			Sasia në litra		Dalje nga magazina	Diferenca në litra	
			Me flete udhëtime	Gjenerat.			
1	2011	458,550	2,320	330	6,080	3,430	545,370
2	2012	480,049	6,290	474	7,171	407	75,295
3	9/M - 2013	94,995	6,168	1,122	7,402	112	20,608
	<b>Shuma</b>	<b>1,033,594</b>	<b>14,778</b>	<b>1,926</b>	<b>20,653</b>	<b>3,949</b>	<b>641,273</b>

Po të analizohen të dhënat e mësipërme rezulton se:

*a.Përdorimi i karburantit.* Për sa i përket vitit 2011 në bazë të fletë udhëtimeve që na u vunë në dispozicion janë harxhuar 2,320 litra karburant për makinat dhe 330 litra për gjeneratorin. Duke i krahasuar me daljet që janë bërë dalje nga magazina një sasi prej 6,080 litra kemi një diferencë prej 3,430 litrash me vlerë prej 545,370 lekë.

Për sa i përket vitit 2012 në bazë të fletë udhëtimeve që na u vunë në dispozicion janë harxhuar 6,290 litra karburant për makinat dhe 474 litra për gjeneratorin. Duke i krahasuar me daljet që janë bërë dalje nga magazina një sasi prej 7,171 litra kemi një diferencë prej 407 litrash me vlerë prej 75,295 lekë.

Për sa i përket 9/M-vitit 2013 në bazë të fletë udhëtimeve që na u vunë në dispozicion janë harxhuar 6,168 litra karburant për makinat dhe 1,122 për gjeneratorin. Duke i krahasuar me daljet që janë bërë dalje nga magazina një sasi prej 7,402 litra kemi një diferencë prej 112 litrash me vlerë prej 20,608 lekë.

*b.Për riparimin e makinave,* në vitin 2011 janë harxhuar 458,550 lekë për të gjitha makinat, vlerë për të cilën nuk e kalon limitin mbi 400 mijë lekë, në bazë të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin pulik” nenet mbi procedurat e zgjedhura të prokurimit publik referuar kufirit të fondit për prokurimin e kryer dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VI pika 1/a. Por këtu është për tu theksuar se përgjegjësi i sektorit të administratës nuk kishte hapur asnjë dosje për çdo makinë ku të evidentoheshin të gjitha shërbimet që i bëheshin makinës dhe me kartela të veçanta ku shënohet çdo pjesë që i vihet dhe i hiqet asaj.

Për sa i përket dokumentacionit të gjeneratorit u verifikuan procesverbalet mujore që nuk janë mbajtur për periudhën objekt kontrolli dhe konkretisht për vitin 2011 janë përkatësisht 22.6 orë pune duke harxhuar 330 litra karburant dmth 14 litra për 1 orë pune. Për vitin 2012 janë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

përkatësisht 31.59 orë pune duke harxhuar 474 litra karburant dhe për 9/M e vitit 2013 janë përkatësisht 74.78 orë pune duke harxhuar 1122 litra karburant. Monitorimi i ndezjes së gjeneratorit nga përgjegjësi i sektorit të administratës nuk është bërë çdo ditë dhe të mbahej një procesverbal ditor ku të tregojë orën e ndezjes dhe orën kur fiket. Kështu është vepruar dhe për vitin 2012 dhe 9/mujorin e vitit 2013. Pra çdo ditë që do të funksionojë gjeneratori (të ndizet) duhet mbajtur një procesverbal ku të pasqyrohet ora e ndezjes dhe ora e fikjes e firmosur nga përgjegjësi i sektorit të shërbimeve. Mbetet pa justifikuar diferenca 3949 litra dhe në vlerë **642,273 lekë**.

#### 4. Zbatimi i ligjmërisë për prokurimet me fondet publike

##### A-Lidhur me përlllogaritjen e fondit limit:

Drejtoria ekonomike ka llogaritur fondin limit (viti 2011) për investime “Blerje makinash” me vlerë 4,166,667 lekë pa TVSH dhe “Blerje pajisje kompjuterike” me vlerë 1,250,000 lekë pa TVSH dhe ja ka dërguar drejtorisë juridike me shkresën nr. 486 Prot. datë 30.06.2011 në zbatim të VKM nr. 173, datë 19.02.2009 dhe në mbështetje të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu II, pika 1, gërma C, “përcaktimi i fondit limit argumentohet nga enti prokurues nisur nga çmimet e publikuara nga INSTAT-i dhe institucione të tjera shtetërore përkatëse. Për çmimet e papublikuara, përcaktimi i fondit limit bëhet nisur nga nevojat e mëparshme të entit prokurues ose sipas testimit të tregut”. Gjithashtu ka llogaritur fondin limit (viti 2012) për investime “Blerje karburanti” me vlerë 2,000,000 lekë pa TVSH dhe ja ka dërguar drejtorisë juridike me shkresën nr. 333 Prot. datë 03.05.2012 në zbatim të VKM-së sipërcituar.

Në mbështetje të pikës 3/e të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu I “Organizimi i Prokurimit Publik”, pika 3, gërma B institucioni ka dërguar në APP regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike dhe përkatësisht për vitin 2011 me shkresë nr. 939/2, datë 10.06.2011 dhe për vitin 2012 me shkresë nr. 290, datë 23.02.2012. Ndërsa regjistri i realizimit të prokurimeve publike nuk është dërguar në APP megjithëse grupit të auditimit ju vunë në dispozicion këta regjistra për vitet 2011-2012 sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

N r	Objekti prokurim.	Fondi limit i prokurimeve		Vlera e prokuruar		Vlera e Kontratës	Koha e zhvill. të tend.	Proced. prokurimit	Firma fitues e
		Inves time	Shpen zime	Invest ime	Shpen zime				
1	Blerje makinash	5,000	0	4,167	0	4,098	09.11.11	Kerkese për propozim	Poche Albania sh.p.k
2	Blerje Pajisje Kompjuteri	3,410	0	1,250	0	1,240	19.12.11	Procedurë me negocim	Computer City
3	Blerje karburanti	0	2,000	0	1,888	1,888	09.07.12	Procedurë me negocim	ENER-AL sh.p.k

**B-Mbi vlerësimin e ofertave për përzgjedhjen e ofertës:**

Nga auditimi u konstatua për vitin 2011-2012:

#### 4.1 “Blerje e dy automjeteve”.

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi nr.259, datë 17.08.2011.	Sara Xhumari-Kryetar Sevada Guço-Anëtar Teuta Bakiri-Anëtar Fatbardh Zenelaj-Anëtar Astrit Goxhaj-Anëtar	Ada Hysi-Anëtar Endrit Koplaku-Anëtar Shejnaze Mane-Anëtar
Vlera e përlogaritur e kontratës 4,166,667 lekë pa TVSH		
Procedurë Kërkesë për propozim, me mjete elektronike ). Hapja e ofertave 02.09.2011 Ora: 11:00		
Janë ftuar të marrin pjesë 6 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 4 operatorë ekonomikë.		
Kontrata me fituesin Nr.567/7 Prot. datë 08.11.2011		
Afati që duhet të lëvrojë mallin brenda 60 ditëve.		

Në bazë të Urdhërit të Prokurimit nr. 259, dt. 17.08.2011, të Kryetarit të KKRT-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përgatiti dhe realizoi Procedurën e Prokurimit Mallra, Kërkesë për Propozim, me objekt “Blerjen e 2 automjeteve” dhe në datën 17.08.2011, u mblodh Njësia e Prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit e cila 5 operatorë ekonomikë, të cilët u ftuan për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi të cilët janë: 1. “Albania Motor Company” sh.p.k. 2, “Classic” sh.p.k. 3, “ANAS” sh.p.k. 4, “KIA” sh.p.k. 5, “Porsche Albania” sh.p.k. Kërkesa për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi iu dërgua operatorëve në mënyrë elektronike, pas botimit të njoftimit të kontratës në buletin e APP-së.

Afati përfundimtar i pranimit të ofertave ishte caktuar data 02.09.2011, ora 11.00. Më datë 02.09.2011, ora 11.00, u deklarua hapja e ofertave si më poshtë:

1-Kadiu me 3,710,000 lekë 2-Hyundai me 4,150,000 lekë 3- Classic me 4,160,000 lekë Albania Motor Company me 4,156,000 lekë dhe Automaster 4,000,000 lekë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas regjistrimit të informacionit të mësipërm, në mbështetje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 «Për prokurimin Publik» i ndryshuar, neni 45 dhe 46 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1, datë 10.01.2007 «Për miratimin e rregullave të prokurimit publik», i ndryshuar, si dhe në dokumentet e tenderit, vendosi të vazhdojë procedurën me shqyrtimin e kërkesave për kualifikim me qëllim verifikimin nëse ofertat e dorëzuara i plotësonin ose jo kërkesat ligjore, administrative dhe kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i gjithë dokumenteve rezultoi se ofertat e paraqitura nga shoqëritë: 1. «Classic» sh.p.k. dhe 2. «Porsche Albania» sh.p.k., ishin në përputhje me kërkesat ligjore, administrative dhe kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe vendosi që t’i kualifikojë këto operatorë ekonomikë. Ndërsa ofertat e operatorëve të mëposhtëm ekonomikë: 1. «Kadiu» sh.a. ; 2. «Hyundai Auto Albania» sh.p.k. 3, «Albania Motor Company» sh.p.k. dhe 4. «Automaster» sh.a. U skualifikuan pasi:

-Shoqëria «KADIU» sh.a., kishte paraqitur ekstraktin e QKR-së të datës 04.05.2011, ekstraktin historik të QKR-së të datës 04.05.2011, si dhe vërtetimin nga Zyra Përmbarimore të datës 03.05.2011, jashtë afatit 3-mujor të kërkuar në kërkesat e përgjithshme për kualifikim. Subjekti nuk





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

kishte paraqitur certifikatë të gjendjes financiare, nuk kishte paraqitur kontratë për furnizime të ngjashme në një shumë deri në 40% të vlerës së kontratës objekt prokurimi, nuk kishte paraqitur certifikatën e origjinës dhe konformitetit për automjetet e ofruara, nuk kishte paraqitur katalogët origjinalë të automjeteve të ofruara.

-Shoqëria «HUYNDAI AUTO ALBANIA» sh.p.k., nga shqyrtimi i vërtetimit të paraqitur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj rezulton se ky subjekt ka detyrime në Tatimin mbi Vlerën e shtuar dhe Tatimin mbi Fitimin.

-Shoqëria «AUTOMASTER» sh.a., nuk kishte paraqitur certifikatën e gjendjes financiare; kontratën për furnizime të ngjashme në një shumë deri në 40% të vlerës së kontratës objekt prokurimi, nuk kishte paraqitur certifikatën e origjinës dhe konformitetit për automjetet e ofruara.

-Shoqëria «Albania Motor Company» sh.p.k., ekstrakti historik i paraqitur prej kësaj shoqërie ishte i paplotë, pasi mungonte fleta e fundit, vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe vërtetimi për pagesën e sigurimeve shoqërore është dorëzuar jashtë afatit 3-mujor të parashikuar në dokumentet e tenderit; kontrata për furnizime të ngjashme është paraqitur në gjuhë të huaj e papërkthyer dhe e pashoqëruar me faturë tatimore shitje, certifikata e origjinës dhe certifikata e konformitetit të automjeteve të ofruara është paraqitur e noterizuar por e papërkthyer. Pasi përfundoi shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të dorëzuara, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në datën 08.09.2011, miratoi klasifikimin përfundimtar, sipas të cilit operatorët që kualifikohen dhe renditja është si më poshtë:

-Në vend të parë **Shoqëria “Porsche Albania”** me vlerë 4.098.000 lekë pa TVSH.

- Në vend të dytë **Shoqëria “Classic” sh.p.k.**, me vlerë 4.160.000 lekë pa TVSH.

Operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi u njoftuan për vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë elektronike nga vetë sistemi.

Para përfundimit të afatit për dorëzimin e ankesave rezulton se 2 operatorë ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi kanë depozituar pranë zyrës së arkivës dhe protokollit të KKRT-së, ankesë ndaj vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tyre.

Kështu me shkresën nr. 1486 prot., datë 14.09.2011, operatori ekonomik “Hyundai Auto Albania” sh.p.k., paraqet ankesë lidhur me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Me shkresën nr.1486/1 prot., datë 20.09.2011, i është kthyer përgjigje operatorit, duke refuzuar kërkesën e tij, pasi pretendimi i tij është gjetur i pambështetur. Subjekti është skualifikuar pasi rezultonte me detyrime tatimore, ndërsa pretendimi i tij lidhur me dimensionet e automjetit të ofruar nga një operator tjetër pjesëmarrës në këtë procedurë nuk qëndron.

Me shkresën nr. 1488 prot., datë 15.09.2011, operatori ekonomik “Automaster” sh.a., paraqet ankesë lidhur me vendimin e KVO për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Me shkresën nr.1488/1 prot., datë 20.09.2011, i është kthyer përgjigje operatorit, duke refuzuar kërkesën e tij, pasi pretendimi i tij është gjetur i pambështetur. Subjekti është skualifikuar për shkak të mangësive në dokumentacionin ligjor, financiar e teknik, ndërsa pretendimi i tij lidhur me gjendjen e konfliktit të interesit midis administratorit të një operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi dhe titullarit të autoritetit kontraktor, KKRT-së, nuk qëndron.

Me shkresën nr. 1535 prot., datë 05.10.2011 (protokollin ynë), të Komisionit të Prokurimit Publik, njoftohemi për pezullimin e procedurës së prokurimit, pasi operatori ekonomik “Hyundai Auto Albania” sh.p.k. kishte paraqitur ankesë në këtë institucion, lidhur me skualifikimin e ofertës së tij. Në përgjigje të kësaj shkrese nga ana e KKRT-së u dërgua informacion i hollësishëm mbi procedurën e zhvilluar të prokurimit, si dhe dokumentacioni i dorëzuar prej operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë. Pas shqyrtimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik, me shkresën nr. 1598. prot, datë 14.10.2011, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga shoqëria “Hyundai Auto Albania” sh.p.k., si dhe lejimin e vazhdimit të procedurave të prokurimit nga ana e AMA-s



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

### **C-Për lidhjen e kontratës midis AK dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues.**

Më datën 08.11.2011 është nënshkruar Kontratë Shërbimi Nr.567/7 Prot, ku shprehen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë palët midis tyre në mbështetje të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Udhëzimet të Agjencisë së Prokurimeve Publike.

### **D-Për ekzekutimin e kontratës, midis AK dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues.**

Më datën 08.11.2011 është nënshkruar Kontratë Shërbimi Nr.567/7 Prot, ku është realizuar brenda afatit kohor prej 60 ditëve.

### **4.2 “Blerje paisje kompjuterike”.**

Lidhur me tenderin me objekt "Blerje pajisje kompjuterike", për vitin 2011, rezulton se, ky tender është realizuar nëpërmjet procedurës "Procedurë me Negocim pa Njoftim Paraparak të Njoftimit të Kontratës". Kjo procedurë është zhvilluar në përputhje me VKM-në nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Zhvillimi i kësaj procedure ka ardhur si rrjedhojë e dështimit të 2 procedurave të njëpasnjëshme “Kërkesë për Propozim”, gjatë muajve Tetor-Nëntor 2011, për shkak të mungesës së konkurrencës. Konkretisht:

(1) Bazuar në Urdhërin nr. 295, datë 20.10.2011, ka filluar procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me objekt “Blerje pajisje kompjuterike”, me fond limit 1.250.000 lekë. Njoftimi për këtë tender është publikuar në buletin e APP-së, të datës 07.11.2011. Në datën 21.11.2011 (data e zhvillimit të tenderit), për shkak të mungesës së konkurrencës, (paraqitur 2 ofertues, nga të cilët vetëm 1 subjekt me ofertë të vlefshme) bazuar në VKM-në nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VII, KVO ka vendosur ndërprerjen e procedurës së prokurimit. Bazuar në shkresën nr.708/3 prot. datë 21.11.2011, të Kryetarit të AMA-s, është njoftuar anulimi i prokurimit. Ky njoftim është publikuar në buletin e APP-së, të datës 28.11.2011.

(2) Mbështetur në Urdhërin nr. 349, datë 22.11.2011, ka filluar për herë të dytë procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me objekt “Blerje pajisje kompjuterike”, me fond limit 1.250.000 lekë. Njoftimi për këtë tender është publikuar në buletin e APP-së, të datës 05.12.2011. Në datën 14.12.2011 (data e zhvillimit të tenderit), për shkak të mungesës së konkurrencës, (paraqitur 2 ofertues, nga të cilët vetëm 1 subjekt me ofertë të vlefshme). Bazuar në shkresën nr. 838/3 prot., datë 19.12.2011, të Kryetarit të AMA-s, është njoftuar anulimi i prokurimit me objekt “Blerje pajisje kompjuterike”.

(3) Pas dështimit të dy procedurave të njëpasnjëshme “Kërkesë për Propozim”, me objekt “Blerje pajisje kompjuterike”, Autoriteti Kontraktor (KKRT), ka çelur procedurën e prokurimit "Procedurë me Negocim pa Njoftim Paraparak të Njoftimit të Kontratës".

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi nr.349/1 datë 19.12.2011.	Sami Nezaj-Kryetar Sara Xhumari-Anëtar Tonin Prenga-Anëtar	Ada Hysi-Anëtar Endrit Kopliku-Anëtar Shejnaze Mane-Anëtar
Vlera e përlllogaritur e kontratës 1,250,000 lekë pa TVSH		
Procedurë me negocim pa botim paraparak		



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

të njoftimit të kontratës. Hapja e ofertave 22.12.2011 Ora: 10:00		
Janë ftuar të marrin pjesë 4 operatorë ekonomik, kanë marrë pjesë 4 dhe KVO ka përzgjedhur 3.		
Kontrata me fituesin Nr.838/12 Prot. datë 29.12.2011		
Afati që duhet të lëvrojë mallin brenda 15 ditëve.		

Në bazë të Urdhërit të Prokurimit nr. 349/1, datë 19.12.2011, të Kryetarit të KKRT.-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përgatitën dhe realizuan Procedurën e Prokurimit, Procedurë me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, me objekt “Blerje pajisje kompjuterike” me fond limit 1,250,000 (një milion e dyqindpesëdhjetëmijë) lekë pa TVSH. Data e paraqitjes së ofertave për pjesmarrje u caktua më 22.12.2011, ora 10.00. Pas kryerjes së verifikimeve në terren, Komisioni përzgjedhi 4 operatorë ekonomikë për t’u dërguar ofertën e tyre ekonomike, në datën e parashikuar, në përgjigje të shkresave të KKRT.-së nr. 838/6 datë 19.12.2011, nr. 838/7, datë 19.12.2011 dhe nr. 838/8, datë 19.12.2011, ishin dorëzuar ofertat përkatëse si më poshtë vijon:

a-Shoqëria “Ario” sh.p.k. Oderta ekonomike e subjektit është 1.248.000 lekë pa TVSH.

b-Shoqëria “Alfa Supplies” sh.p.k. Oferta ekonomike e subjektit është 1.244.000 lekë pa TVSH.

c-Shoqërisa “Computer City” sh.p.k. Oferta ekonomike e subjektit është 1.240.000 lekë pa TVSH.

Sa më sipër rezultoi se, oferta e shoqërisë “Computer City” sh.p.k., ishte oferta më e suksesshme dhe Komisioni vendosi t’i drejtohej kësaj shoqërie për të depozituar dokumentacionin tekniko-ligjor. Bashkëlidhur procesverbali nr. 838/9 prot., datë 22.12.2011. Në datën 29.12.2011, KVO dhe Njësia e Prokurimit, procedoi me hapjen e dosjes të dorëzuar nga subjekti “Computer City” sh.p.k. Në përfundim të vlerësimit dhe shqyrtimit tërësor të dokumentacionit të paraqitur nga kjo firmë, KVO dhe Njësia e Prokurimit konstatoi se, dokumentacioni i paraqitur nga kjo shoqëri ishte në përputhje me kërkesat e miratuara nga ky komision në bazë procesverbalit nr. 838/11 prot., datë 29.12.2011 miratoi shpalljen e fituesit.

*Për lidhjen e kontratës midis AK dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues.*

Më datën 29.12.2011 është nënshkruar Kontratë Shërbimi Nr.838/12 Prot, ku shprehen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë palët midis tyre në mbështetje të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Udhëzimet të Agjencisë së Prokurimeve Publike.

*Për ekzekutimin e kontratës, midis AK dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues.*

Më datën 29.12.2011 është nënshkruar Kontratë Shërbimi Nr.838/12 Prot, ku është realizuar brenda afatit kohor prej 15 ditëve.

### **4.3 “Blerje karburanti”.**

Lidhur me tenderin me objekt "Blerje Karburanti", për vitin 2012, rezulton se, ky tender është realizuar nëpërmjet procedurës "Procedurë me Negocim pa Njoftim Paraprak të Njoftimit të Kontratës". Kjo procedurë është zhvilluar në përputhje me VKM-në nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Zhvillimi i kësaj procedure ka ardhur si



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

rrjedhojë e dështimit të 4 procedurave të njëpasnjëshme “Kërkesë për Propozim” dhe 1 procedure “Procedurë me Negociim pa Njoftim Paraprak të Njoftimit të Kontratës”, gjatë muajve Janar-Qershor 2012, për shkak të mungesës së konkurrencës. Konkretisht:

**a-** Bazuar në Urdhërin nr. 06, datë 09.01.2012, ka filluar procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me objekt “Blerje karburanti”, me fond limit 1.250.000 lekë. Njoftimi për këtë tender dhe dokumentat e tenderit janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të APP-së . Në datën 17.12.2011 (data e zhvillimit të tenderit), për shkak të mungesës së konkurrencës (nuk është paraqitur asnjë ofertë), bazuar në VKM-në nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VII, KVO ka vendosur ndërprerjen e procedurës së prokurimit. Bazuar në shkresën nr. 20/4 prot., datë 17.12.2012, të Kryetarit të AMA-s, është njoftuar anulimi i prokurimit me objekt “Blerje Karburanti”.

**b-** Mbështetur në Urdhërin nr. 45, datë 20.02.2012, ka filluar procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, KVO ka vendosur ndërprerjen e procedurës së prokurimit. Bazuar në shkresën nr. 144/6 prot., datë 19.03.2012, të Kryetarit të AMA-s, është njoftuar anulimi i prokurimit me objekt “Blerje Karburanti”.

**c-** Bazuar në Urdhërin nr. 72, datë 28.03.2012, ka filluar procedura e prokurimit “Procedurë me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”. Në datën 06.04.2012, duke qënë se nuk u paraqit asnjë nga firmat e ftuara për të marrë pjesë në tender, për shkak të mungesës së konkurrencës, bazuar në VKM-në nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VII, KVO ka vendosur ndërprerjen e procedurës së prokurimit dhe fillimin e një procedure të re.

**d-** Në përfundim të 3 procedurave të mësipërme të prokurimit, AK ka ndryshuar fondin limit dhe ka filluar një procedurë të re prokurimi me objekt “Blerje Karburanti”. Mbështetur në Urdhërin nr. 93, datë 07.05.2012, ka filluar procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me objekt “Blerje karburanti”, me fond limit 2.000.000 lekë. Njoftimi për këtë tender dhe dokumentat e tenderit janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të APP-së . Në datën 29.05.2012 (data e zhvillimit të tenderit), për shkak të mungesës së konkurrencës, (nuk është paraqitur asnjë ofertë), KVO ka vendosur ndërprerjen e procedurës së prokurimit. Bazuar në shkresën nr. 346/4 prot., datë 30.05.2012, të Kryetarit të AMA-s, është njoftuar anulimi i prokurimit me objekt “Blerje Karburanti”.

**e-** Mbështetur në Urdhërin nr. 93/1, datë 30.05.2012, ka filluar procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”. Në datën 13.06.2012, në përfundim të vlerësimit dhe shqyrtimit tërësor të ofertave të paraqitura, për shkak të mungesës së konkurrencës, (nuk është paraqitur asnjë ofertë), KVO ka vendosur ndërprerjen e procedurës së prokurimit. Bazuar në shkresën nr. 346/8 prot., datë 22.06.2012, të Kryetarit të AMA-s, është njoftuar anulimi i prokurimit me objekt “Blerje Karburanti”.

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna mbi tenderin	Komisionii vlerësimit të ofertave	Njësiat e prokurimit
Urdhër prokurimi nr.147 datë 04.07.2012.	Sami Nezaj-Kryetar Sara Xhumari-Anëtar Tonin Prenga-Anëtar	Ada Hysi-Anëtar Endrit Kopluku-Anëtar Shejnaze Mane-Anëtar
Vlera e përlllogaritur e kontratës 2,000,000 lekë pa TVSH.		
Procedurë me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës. Hapja e ofertave 05.07.2011 Ora: 10:00		
Janë ftuar të marrin pjesë operatorë ekonomik, kanë marrë pjesë 4 dhe KVO		



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

ka përzgjedhur 3.		
Kontrata me fituesin Nr.506/7 Prot. datë 09.07.2012		
Afati që duhet të lëvrojë mallin brenda 1 viti 09.07.2012-09.07.2013		

Në bazë të Urdhërit të Prokurimit nr. 147, datë 04.07.2012, nr. 506 prot., të Kryetarit të KKRT.-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përgatitën dhe realizuan Procedurën e Prokurimit, Procedurë me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, me objekt "Blerje Karburanti", me fond limit 2.000.000 (dymilion) lekë pa TVSH. Data e paraqitjes së ofertave për pjesmarrje u caktua më datë 05.07.2012, ora 10.00. Pas kryerjes së verifikimeve në terren, Komisioni përzgjodhi 4 operatorë ekonomikë për t'u dërguar ofertën e tyre ekonomike, në datën e parashikuar, si më poshtë vijon:

1-Shoqëria "Ener-AL" sh.p.k. 2-Shoqëria "Ora Petrol". 3-Shoqëria "Efor-K" sh.p.k.  
4-Shoqëria "Flladi" sh.p.k.

Në përgjigje të shkresave të KKRT-së nr. 977 prot., 978 prot., 979 prot., 980 prot., datë 04.07.2012, ishin dorëzuar ofertat përkatëse si më poshtë:

a-Shoqëria "Flladi" sh.p.k. Oferta ekonomike e subjektit është 1.912.460 lekë pa TVSH. Marzhi i fitimit me i ulët 17% për benzinën dhe 14% për gazoil.

b-Shoqëria "Ener -AL" sh.p.k. Oferta ekonomike e subjektit është 1.888.340 lekë pa TVSH. Marzhi i fitimit me i ulët 16% për benzinën dhe 13% për gazoil.

c-Shoqëria "Efor-K" sh.p.k. Oferta ekonomike e subjektit është 1.908.360 lekë pa TVSH. Marzhi i fitimit më i ulët 17% për benzinën dhe 14% për gazoil.

Sa më sipër rezultoi se, oferta e shoqërisë "Ener-AL" sh.p.k., ishte oferta më e suksesshme dhe Komisioni vendosi t'i drejtohej kësaj shoqërie për të depozituar dokumentacionin tekniko-ligjor në bazë të procesverbalit nr.506/2 prot. datë 05.07.2012. Në datën 06.07.2012, KVO dhe Njësia e Prokurimit, konstatoi se, dokumentacioni i paraqitur nga kjo shoqëri ishte në përputhje me kërkesat e miratuara nga ky komision në bazë të procesverbalit nr.506/4 prot. datë 06.07.2012 ku miratoi shpalljen e fituesit.

*Për lidhjen e kontratës midis AK dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues.*

Më datën 09.07.2012 është nënshkruar Kontratë Shërbimi Nr.506/7 Prot, ku shprehen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë palët midis tyre në mbështetje të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", Ligjin nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM-në nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, Udhëzimet të Agjencisë së Prokurimeve Publike.

*Për ekzekutimin e kontratës, midis AK dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues.*

Më datën 09.07.2012 është nënshkruar Kontratë Shërbimi Nr.506/7 Prot, ku është realizuar brenda afatit kohor 09.07.2012 deri më 09.07.2013.

## 5. Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave

### 5.1 Burimet e krijimit të të ardhurave

Autoriteti i Mediave Audiovizive sipas nenit 11 të ligjit Nr. 8410, datë 23.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ka të përcaktuara burimet e financimit dhe janë:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave, të ardhura nga pagesa vjetore të licencës, të ardhura nga përpunimi i kërkesave për licensim, të ardhurat nga taksat për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive të caktuara në ligjet fiskale.

**Për vitin 2011** në mënyrë të detajuar të ardhurat dhe taksat paraqiten:

Nr.	EMËRTIMI	PLANI	FAKTI	Në lekë
				Në %
1	Pagesë për licencë 2011	80,150,000	48,359,519	60
2	Pages për marrjen e licences	1,800,000	0	0
3	Të ardhura agjent tatimor	1,200,000	762,902	64
4	Pagesë për përp. dokumen.	1,800,000	1,545,000	86
5	Interesa bankare	1,000,000	264,811	26
6	Të ardhura të tjera	100,000	63,225	63
	Pagesë për licencë vite kaluar	0	10,225,059	
8	Financ. nga të ardhurat e akumul.	3,020,000	0	0
	<b>Shuma :</b>	<b>89,070,000</b>	<b>61,220,516</b>	<b>69</b>
9	Të ardhura nga Projekti See Digi Tv	0	5,768,946	
	<b>GJITHSEJ :</b>	<b>89,070,000</b>	<b>66,989,462</b>	<b>76</b>
	Taksa të arkëtuara		16,081,620	
	<b>GJITHSEJ :</b>	<b>89,070,000</b>	<b>83,071,082</b>	

Të ardhurat në total janë realizuar 69 % - nga pagesat për licencat është realizuar në masën 60 % që zë dhe peshën kryesore të të ardhurave për institucionin, arkëtimet për licencat nga vitet e kaluar zënë 13 % të planit.

**Për vitin 2012** të ardhurat dhe taksat paraqiten:

Nr.	EMËRTIMI	PLANI	TË ARDHURA	Në lekë
				Në %
1	Pagesë për licencë	93,450,000	31,954,070	34
2	Pages për marrjen e licences	1,500,000	750,000	50
3	Të ardhura agjent tatimor	1,200,000	519,455	43
4	Pagesë për përp. dokumen.	1,600,000	975,000	61
5	Interesa bankare	500,000	371,182	74
6	Të ardhura të tjera	200,000	32,070	16
7	Pagesë për licencë vite kaluar	0	27,147,386	
	<b>Shuma :</b>	<b>98,450,000</b>	<b>61,749,163</b>	<b>63</b>
	Taksa të arkëtuara		12,284,111	
	<b>GJITHSEJ :</b>	<b>98,450,000</b>	<b>74,033,274</b>	<b>63</b>

Të ardhurat në total janë realizuar 63 % - nga pagesat për licencat është realizuar në masën 34 % duke e krahasuar me vitin 2011 pagesa nga licencat është ulur ndjeshëm rreth 50%.

**Për 9/mujorin 2013** të ardhurat dhe taksat paraqiten:

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Në lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLANI	TË ARDHURA	Në %
1	Pagesë për licencë	107,450,000	15,927,624	15
2	Pages për marrjen e licences	1,500,000	305,000	20
3	Të ardhura agent tatimor	1,200,000	507,397	42
4	Pagesë për përp. dokumen.	1,600,000	415,000	26
5	Interesa bankare	1,000,000	316,963	32
6	Të ardhura të tjera	200,000	17035	9
7	Pagesë për licencë vite kaluar	0	39,870,770	
	<b>Shuma :</b>	<b>112,950,000</b>	<b>57,359,789</b>	<b>51</b>
	Derdhur Taksa		17,645,300	
	<b>GJITHËSEJ :</b>	<b>112,950,000</b>	<b>75,005,089</b>	<b>66</b>

Të ardhurat nga licencat (pagesat) për 9/mujorin janë realizuar vetëm 15 % e tyre, por ka rritje në arkëtimin për licencat e viteve të kauar.

Duke krahasuar realizimin e të ardhurave nga viti në vit ka ardhur në rënie, kjo vjen si rezultat i mos zbatimit të saksioneve ligjore ndaj operatorëve në momentin e ripërtëritjes së licencave.

Nga auditimi del qartë se në mbullje të rezultatit vjetor enti ka morealizime të të ardhurave, për mbulimin e shpenzimeve e ka kompesuar me gjendjen e viteve të mëparshëm.

**5.2 Përdorimi i të ardhurave.**

Nga auditimi për përdorimin e të ardhurave nga institucioni rezulton se janë përdorur kryesisht për pagat,shpenzime me të tretët,udhëtim dhe dieta, transporte.

Përdorimi i të ardhurave viti 2011 dhe paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Nr	EMËRTIMI	PLANI	REALIZIMI	Në %
1	Paga dhe shpërblime	49,000,000	45,247,707	93
2	Kontribut i sig. Shoqërore	7,300,000	6,319,945	87
3	Shpenzime tretet,udh,dieta.trans.e tjera	20,760,000	18,071,836	83
4	Shpenzime të paparashikuara	0	6,087,171	
5	Investime	12,010,000	8,060,919	68
	<b>SHUMA</b>	<b>89,070,000</b>	<b>83,787,578</b>	<b>94</b>

Në zërin shpenzime të paparashikuara në vlerën 6,087,171 lekë, detyrimet të likujduar punonjesve që janë pezulluar nga puna dhe kanë fituar pagën me vendime gjyqësore.

Përdorimi i të ardhurave viti 2012 dhe paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Nr	EMËRTIMI	PLANI	REALIZIMI	Në %
1	Paga dhe shpërblime	48,600,000	44,613,729	93
2	Kontribut i sig. Shoqërore	7,300,000	6,319,945	87
3	Shpenzime tretet,udh,dieta.trans.e tjera	20,760,000	21,039,951	83
4	Detyrime dhe kompesime	20,500,000	9,545,451	
5	Investime	300,000	325,620	
	<b>SHUMA</b>	<b>97,400,000</b>	<b>881844,696</b>	<b>94</b>



Duke krahasuar vitin 2011 me 2012 rezulton se, përdorimi i të ardhurave ka ardhur në rritje me 8,330,000 lekë, zëri paga dhe sigurime shoqërore që zë dhe peshën kryesore ka ardhur në ulje, por detyrime dhe kompesime 20,500 mijë lekë është planifikuar dhe miratuar për të likuiduar punonjesve që janë pezulluar nga puna dhe kanë fituar pagën me vendime gjyqësore dhe e realizuar 9,545 mijë lekë (*Shkeljet në përdorimin e të ardhurave janë pasqyruar në 3.2 Mallra dhe shërbime (llog.602)*)

## 6. Licencimi i operatorëve televizivë privatë kabllor dhe inspektive tyre

### 6.1 Licencimi i operatorëve televizivë privatë kabllor

Sipas dispozitave të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, licencimi i **subjekteve si operatorë televizive private kabllore, kryhet nëpërmjet procesit të licencimit**. Neni 124, i ligjit të sipërcituar përcaktonte se: “*Procedura dhe kërkesat e tjera të nevojshme për marrjen e licencës, si dhe të drejtat e detyrimet e subjekteve janë të njëjta me ato që parashikohen për licencat e transmetimeve radiotelevizive në efir të përshkruara në kreun IV të këtij ligji*”. Në zbatim të kërkesave ligjore, nga ana e KKRT-së ( AMA) janë miratuar tre rregullore:

a-“Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.03.2004, të ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”.

b-“Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr.355, datë 29.08.2005.

c-“Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 01, datë 29.01.2010.

Mbi bazën e kërkesave të paraqitura nga subjektet e interesuara, Këshilli, miraton me vendim, organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë radiotelevizivë kabllorë , duke përcaktuar edhe zonat për të cilat do të kryhej licencimi. Botohej në dy gazeta “Njoftimi për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë radiotelevizivë kabllorë” dhe shpallej publikisht njoftimi në RTSH, duke dhënë informacion të plotë mbi dokumentacionin e aplikimit. Pas kalimit të afatit 30 ditor nga shpallja e konkurrimit, mbështetur në Rregulloren “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve private radio e televizive”, miratuar me vendimin nr. 01, datë 29.01.2010 të KKRT-së, titullari ngre Komisionin e Shqyrtimit të Dokumentacionit i cili shqyrtorn aplikimet për licencim. Në datën dhe orën e planifikuar si afat i fundit i paraqitjes së propozimeve, punonjësi i protokollit i përcjell Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, të gjithë zarfat e depozituara nga aplikantët, të cilët duhet të jenë të pahapura. Komisioni fillimisht bën verifikimin në se dosjet e aplikimit janë të mbyllura, të firmosura e të vulosura dhe më pas procedohet me hapjen e secilit zarf dhe shqyrtimin e dokumentacionit që përmban zarfi i aplikimit. Pas hapjes së zarfit, çdo dokument numërtohet nga sekretari i Komisionit, në prezencë të Komisionit i cili verifikon në se dokumentacioni i aplikimit i paraqitur nga subjektet që kërkojnë të licencohen, është në përputhje me njoftimin e bërë në shtyp. Pas këtij verifikimi, dokumentacioni shqyrtohet në mënyrë të hollësishëm nga anëtarët e Komisionit i cili, përgatit një relacion vlerësimi, i cili së bashku me procesverbalin e mbajtur nga sekretari, nënshkruhen nga të gjithë të pranishmit.

Relacioni së bashku me procesverbalin i përcillen me protokoll Drejtorisë Juridike dhe të Licencave, e cila i përfshin në materialet e mbledhjes së radhës të autoritetit mbi licencimin e subjekteve si operatorë televizive private analogë televizivë apo radio. Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë për radio apo tv, paraqesin pranë KKRT-së letrën e interesit, të cilës i kthehet





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

përgjigje nga Drejtoria Juridike dhe e Licencave në KKRT, brenda afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative. Drejtoria Teknike bën studimin e spektrit të frekuencave radiotelevizive e në rast të ekzistencës së mundësive teknike dhe ligjore në realizimin e tyre, njofton KKRT-në, për mundësinë e shpalljes në mënyrë publike të konkurrimit të kandidatave. Procedura vazhdon njësoj si më sipër.

Vendimet e licencimit për TV kabllore, radio private vendore dhe TV private vendore të AMA-s për vitin 2011 janë:

Nr.	Nr. i vendim.	Dt. e vendimit	Titulli i vendimit	Zona e licencimit
1.	109	28.03.11	Për dhënie licence "Tv kabllor Lapardha" (Shaban Merkaj)	Komuna Otlak
2.	110	28.03.201	Për dhënie licence "Tv kabllor Ard&Net" (Vullnet Nazëraj)	Komuna Frakull
3.	111	28.03.2011	Për dhënie licence "Tv kabllor Mamurras" (Gjergj Gega)	Qyteti Mamurras
4.	112	28.03.2011	Për dhënie licence "Tv kabllor Orexh" (Engjëllushe Veliaj)	Komuna Mrostar dhe fshati Patos
5.	113	28.03.2011	Për dhënie licence "Tv kabllor Alfa Hajdini" (Bilbil Hajdini)	Qyteti Fier
6.	115	28.03.2011	Për dhënie licence "Tv kabllor Zargoçan" (Gëzim Cake)	Fshati Zargoçan
7.	116	28.03.2011	Për dhënie licence "Tv kabllor 2Asl" (Arben Asllani)	Komunat Shirgjan dhe Funar
8.	117	28.03.2011	Për dhënie licence "Tv kabllor Pirg" ( Fredi Hasa)	Komuna Pirg
9.	118	28.03.2011	Për dhënie licence "Tv kabllor Brado" (Adem Boriçi)	Komuna Bradashesh
10.	119	28.03.2011	Për dhënie licence "Tv kabllor Masa Grup" ("Masa Grup 2009" sh.p.k.)	Komunat Vreshtas dhe Pirg
11.	120	28.03.2011	Për dhënie licence radio vendore "Abc Neës" (Shoqëria "Abc Neës" sh.a.)	Rrethet Tiranë-Durrës, qyteti Fier dhe qarku Vlorë
12.	121	28.03.2011	Për dhënie licence radio vendore "Radio Epiri 2011" (Shoqëria "Radio Epiri" sh.p.k.)	Rrethi Gjirokastër
13.	159	31.05.2011	"Për dhënie licence tv kabllor "Cable Albania Gjirokastër" (shoqëria "Cable Albania Gjirokastër"	Qyteti Gjirokastër
14.	160	31.05.2011	"Për dhënie licence tv kabllor "Cable Albania Kombi" (shoqërisë "Cable Albania Kombi" sh.p.k.)	Qyteti Fier
15.	161	31.05.2011	Për dhënie licence tv kabllor "Cable Albania Lushnje" (shoqëria "Cable Albania Lushnje" sh.p.k.)	Qyteti Lushnje
16.	162	31.05.2011	"Për dhënie licence tv kabllor "Cable Albania Elbasan North" (shoqëria "Cable Albania Elbasan North" sh.p.k.,)	Qyteti Elbasan
17.	163	31.05.2011	"Për dhënie licence shoqërisë "Cable Albania Elbasan South" sh.p.k., për televizionin privat kabllor "Cable Albania Elbasan South".	Qyteti Elbasan
18.	164	31.05.2011	"Për dhënie licence tv kabllor "Cable Albania Kavajë"(shoqëria "Cable Albania Kavajë" sh.p.k.)	Qyteti Kavajë
19.	165	31.05.2011	Për dhënie licence tv kabllor "Cable Albania Durrës"(shoqëria "Cable Albania Durrës" sh.p.k.)	Qyteti Durrës
20.	166	31.05.2011	"Për dhënie licence tv kabllor "Cable Albania Tiranë" (shoqëria "Cable Albania Tiranë" sh.p.k.)	Qyteti Tiranë
21.	167	31.05.2011	"Për dhënie licence tv kabllor "Cable Albania Shkodër" (shoqëria "Cable Albania Shkodër" sh.p.k.)	Qyteti Shkodër
22.	168	31.05.2011	"Për dhënie licence tv kabllor "Tv kabllor Epiri 2011" (shoqëria "Epiri 2011" sh.p.k.)	Qarku Gjirokastër
23.	182	30.06.2011	Për dhënie licence radio vendore "Radio Dimension"	Rrethi Shkodër



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

			(Shoqëria "Ftoni A" sh.p.k.)	
24.	183	30.06.2011	Për dhënie licence radio vendore "Radio Hit Fm" (Shoqëria "Radio Hit Fm" sh.p.k.)	Rrethi Elbasan
25.	184	30.06.2011	Për dhënie licence radio vendore "Radio Univer" (Shoqëria "Radio Univer" sh.p.k.)	Qarqet Tiranë – Durrës – Fier – Vlorë
26.	185	30.06.2011	Për dhënie licence radio vendore "Radio Number One" (Shoqëria "Radio Number One" sh.p.k.)	Qarqet Tiranë – Durrës – Fier – Vlorë
27.	186	30.06.2011	Për dhënie licence radio vendore "Radio Sprint" (Julian Sejko)	Rrethi Gjirokastër
28.	208	25.07.2011	"Për dhënie licence radio vendore "City Radio Albania" (shoqëria "City Radio Albania")	Rrethet Tiranë – Durrës
29.	209	25.07.2011	"Për dhënie licence radio vendore "Radio Clazz" (shoqëria "Clazz Radio" sh.p.k.)	Qarqet Tiranë – Durrës – Fier – Vlorë
30.	235	03.10.2011	"Për dhënie licence tv vendor "TV AdriaMed", (shoqëria "Adria Med" sh.p.k.)	Rrethi Durrës; rrethi Kavajë, qarqet Fier dhe Vlorë;
31.	236	03.10.2011	"Për dhënie licence tv vendor "TV Best", (shoqëria "TV Best" sh.p.k.)	Qarku Elbasan
32.	238	03.10.2011	"Për dhënie licence tv kabllor "CA-TV Përmet", (Anduel Shabani)	Qyteti Përmet
33.	265	30.11.2011	"Për dhënie licence radio vendore "Radio 7 Nord" (Shoqëria "Good Neës J-Media" sh.p.k.)	Rrethi Shkodër
34.	267	30.11.2011	"Për dhënie licence tv kabllor "TV Kabllor Ergi" (Erjon Keta)	Komunat Rashbull dhe Shënvllash

Vendimet e licencimit për TV kabllore, radio private vendore dhe TV private vendore të AMA-s për vitin 2012 janë:

Nr.	Nr. i vendimit	Dt. e vendimit	Titulli i vendimit	Zona e licencimit
1.	27	26.03.2012	Për dhënie licence tv kabllor "TV Kabllor Ordea" (Shpresa Shaqi)	Rrethi Devoll dhe komuna Ligenas
2.	28	26.03.2012	Për dhënie licence tv kabllor "TV Kabllor Lin" (Josif Shegani)	Fshati Lin
3.	29	26.03.2012	Për dhënie licence tv kabllor "TV Kabllor Manastiri" (Arben Nazëraj)	Komuna Kolonjë
4.	31	26.03.2012	Për dhënie licence tv vendor "TV Veleçiku" (Shoqëria "Veleçiku" sh.p.k.)	Rrethi Shkodër
5.	32	26.03.2012	Për dhënie licence radio vendore "Radio Motiv" (Shoqëria "Media Motiv" sh.a.)	Rrethi Shkodër
6.	95	27.07.2012	Për dhënie licence tv kabllor "TV Kabllor Fier-Shegan" (Bajram Skraqi)	Komuna Fier-Shegan
7.	96	27.07.2012	Për dhënie licence tv kabllor "TV Kabllor Arten" (Arben Mërtiri)	Komunat Bubullimë dhe Gradishtë
8.	124	24.09.2012	Për dhënie licence radio vendore "Capital Radio" (Shoqëria "Capital Radio" sh.p.k.)	Rrethet Tiranë-Durrës
9.	125	24.09.2012	Për dhënie licence radio vendore "Radio Glob" (Emiljano Hoxhaj)	Qyteti Berat
10.	126	24.09.2012	Për dhënie licence tv kabllor "TV	Qyteti Kuçovë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

			Kabllor Dire” (Ardian Sulovari)	
11.	167	28.12.2012	Për dhënie licence radio vendore “City FM” (Shoqëria “City FM” sh.p.k.)	Qarku Korçë
12.	171	28.12.2012	Për dhënie licence radio me përsëritës “CRI Radio e Jashtme e Kinës” (shoqëria “ALB-CRTV” sh.p.k.)	Rrethet Tiranë-Durrës
13.	172	28.12.2012	Për dhënie licence tv kabllor “TV Kabllor Apoll net” (shoqëria “Apoll Net” sh.p.k.)	Qyteti Fier

Vendimet e licencimit për TV kabllore, radio private vendore dhe TV private vendore të AMA-s për vitin 2012 janë:

Nr.	Nr. Vendimit	Dt. e vendimit	Titulli i vendimit	Zona e licencimit
1.	36	01.02.2013	Për dhënie licence tv kabllor “TV Next Kabëll”	Bashkia Kamëz
2.	100	03.04.2013	Për dhënie licence radio vendore “Radio Living” (Shoqëria “J&P PRO” sh.p.k.)	Rrethet Tiranë-Durrës
3.	101	03.04.2013	Për dhënie licence radio vendore “Radio Spektrum” (Shoqëria “VALA 2013” sh.p.k.)	Rrethet Tiranë-Durrës
4.	102	03.04.2013	Për dhënie licence tv kabllor “TV Info Kabëll”	Rrethet Tiranë-Durrës
5.	8	22.05.2013	“Mbi ofrimin e shërbimit të programit audioviziv satelitor “TV Agon Channel”	Satelitor

Me zgjedhje u audituan këto dosje:

### **6.1.1. Subjekti “TV Kabllor Alfa Hajdini”, personi fizik Alfa Hajdini.**

KKRT në mbështetje të nenit 7, pika 21 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 01, datë 29.01.2010, me vendimin nr. 7, datë 29.01.2010, ka vendosur të shpallë në mënyrë publike, konkurrimin e kandidaturave për operatorë privatë analogë radiofonikë. Me urdhërin nr.59, datë 01.03.2011 të Kryetarit të KKRT-së është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe në datën 02.03.2011, është hapur aplikimi i subjektit. Personi fizik Bilbil Hajdini ka paraqitur aplikimin për licencë për licencim për televizionin kabllor, me shkresën nr.353 prot. datë 28.02.2011. Sipas procesverbalit nr. 136 prot. datë 02.03.2011, të mbajtur nga KSHD, fillimisht është bërë verifikimi i aplikimit të subjektit. Pasi ka rezultuar se ky aplikim ishte në përputhje me kërkesat ligjore, mbështetur në pikën 16 të rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me Vendimin nr. 01, datë 29.01.2010, të KKRT-së, Komisioni vazhdoi procedurën me verifikimin e dokumentacionit të aplikimeve të paraqitura lidhur me përputhshmërinë e tyre me rregulloren “Kriteret për dhënien e licencave për transmetime radio FM dhe televizive” dhe me rregulloren “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr. 221, datë 30.03.2004, të ndryshuar dhe me njoftimin e bërë në shtyp.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Anëtarët e KSHD-së kanë përgatitur relacionet e vlerësimit sipas kompetencës me vlerësime pozitive dhe ka përgatitur relacionin përmbledhës të cilin ia ka përcjellë KKRT-së, në mbledhjen e rradhës të zhvilluar në datën 28.03.2011, duke propozuar dhënien e licencës për personin fizik Bilbil Hajdini, për televizionin privat kabllor “TV Kabllor Alfa Hajdini“. KKRT, me vendimin nr. 113, datë 28.03.2011 ka miratuar dhënien e licencës për këtë subjekt.

### **6.1.2 Subjekti radiofonik “Radio Epiri 2011”, shoqëria “Radio Epiri”.**

Me urdhërin nr. 77, datë 21.03.2011 të Kryetarit të KKRT-së, është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe në datën 23.03.2011, është hapur aplikimi i subjektit. Shoqëria “Radio Epiri 2011“ sh.p.k., ka paraqitur aplikimin për licencë për radio me shkresën nr. 490 prot., datë 23.03.2011, për rrethin Gjirokastër, frekuenca 96.4 MHz. Sipas procesverbalit nr.175 prot. datë 23.03.2011, të mbajtur nga KSHD, fillimisht është bërë verifikimi i aplikimit të subjektit. Pasi ka rezultuar se ky aplikim ishte në përputhje me kërkesat ligjore, mbështetur në pikën 16 të rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me Vendimin nr. 01, datë 29.01.2010, të KKRT-së, Komisioni ka vazhduar procedurën mbi verifikimin e dokumentacionit të aplikimeve të paraqitura lidhur me përputhshmërinë e tyre me rregulloren “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregulloren “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, datë 29.08.2005 dhe me njoftimin e bërë në shtyp. Anëtarët e KSHD-së kanë përgatitur relacionet e vlerësimit pozitiv sipas kompetencës dhe ka përgatitur relacionin përmbledhës të cilin ia ka përcjellë KKRT-së, në mbledhjen e rradhës të zhvilluar në datën 28.03.2011, duke propozuar dhënien e licencës për shoqërinë “Radio Epiri 2011“ sh.p.k., për radion private vendore “Radio Epiri“. KKRT, me vendimin nr. 182, datë 30.06.2011 ka miratuar dhënien e licencës për këtë subjekt.

### **6.1.3. Subjekti “TV Kabllor Cable Albania Kombi”, shoqëria “TV Kabllor Cable Albania Kombi” sh.p.k.**

Me urdhërin nr.116, datë 31.03.2011 të Kryetarit të KKRT-së është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe në datën 18.04.2011, është hapur aplikimi i subjektit. Shoqëria “TV Kabllor Cable Albania Kombi” sh.p.k. ka paraqitur aplikimin për licencë për televizionin kabllor me shkresën nr. 730 prot. datë 18.04.2011. Sipas procesverbalit nr. 224/1 prot., datë 18.04.2011, të mbajtur nga KSHD, fillimisht është bërë verifikimi i aplikimit të subjektit. Pasi ka rezultuar se ky aplikim ishte në përputhje me kërkesat ligjore, mbështetur në pikën 16 të rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me Vendimin nr. 01, datë 29.01.2010, të KKRT-së. Komisioni vazhdoi procedurën me verifikimin e dokumentacionit të aplikimeve të paraqitura lidhur me përputhshmërinë e tyre me rregulloren “Kriteret për dhënien e licencave për transmetime radio FM dhe televizive” dhe me rregulloren “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr. 221, datë 30.03.2004, të ndryshuar dhe me njoftimin e bërë në shtyp. Nga verifikimi paraprak i dokumentacionit të aplikimeve, rezultoi se aplikimi i subjekti Cable Albania, nuk i plotësonte kërkesat e rregullores, pasi nuk kishte paraqitur garancinë bankare në masën 10% të kapitalit themeltar. Komisioni vendosi në mënyrë unanime skualifikimin e aplikimit. Më tej me shkresën nr. 950/7 prot., datë 30.05.2011, shoqëria “TV Kabllor Cable Albania Kombi” sh.p.k. ka depozituar kërkesë për t’u licencuar duke paraqitur garancinë bankare në masën 10% të kapitalit financiar nga Banka Raiffeisen. KKRT në mbledhjen e rradhës të zhvilluar në datën 31.05.2011, me vendimin nr.160, pasi është njohur edhe me kërkesën e subjektit si dhe dokumentacionin e paraqitur, vendosi të licencojë shoqërinë “TV Kabllor Cable Albania Kombi” sh.p.k. për televizionin privat kabllor “TV Kabllor Cable Albania Kombi“.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

### 6.1.4. Subjekti radiofonik “Radio Dimension”, shoqëria “Ftoni A” sh.p.k.

Me urdhërin nr.122, datë 16.06.2011 të Kryetarit të KKRT-së është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe në datën 17.06.2011, është hapur aplikimi i subjektit. Shoqëria “Ftoni A” sh.p.k., ka paraqitur aplikimin për licencë për radio me shkresën nr. 1078 prot. datë 16.06.2011. Sipas procesverbalit nr. 478 prot., datë 17.06.2011, të mbajtur nga KSHD, fillimisht është bërë verifikimi i aplikimit të subjektit. Pasi ka rezultuar se ky aplikim ishte në përputhje me kërkesat ligjore, mbështetur në pikën 16 të rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me Vendimin nr. 01, datë 29.01.2010, të KKRT-së, Komisioni vazhdoi procedurën me verifikimin e dokumentacionit të aplikimeve të paraqitura lidhur me përputhshmërinë e tyre me rregulloren “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregulloren “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, datë 29.08.2005 dhe me njoftimin e bërë në shtyp. Anëtarët e KSHD-së kanë përgatitur relacionet e vlerësimit pozitiv sipas kompetencës dhe relacionin përmbledhës të cilin ia ka përcjellë KKRT-së, në mbledhjen e rradhës të zhvilluar në datën 30.06.2011, duke propozuar dhënien e licencës për shoqërinë “Ftoni A” sh.p.k., për radion private vendore “Dimension”. KKRT, me vendimin nr. 182, datë 30.06.2011 ka miratuar dhënien e licencës për këtë subjekt.

### 6.1.5. Subjekti radiofonik “City Radio Albania”, shoqëria “City Radio Albania” sh.p.k.

Me urdhërin nr.134, datë 12.07.2011 të Kryetarit të KKRT-së është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe në datën 14.07.2011, janë hapur aplikimet e depozituara nga subjektet e interesuara. Shoqëria “City Radio Albania” sh.p.k., ka paraqitur aplikimin për licencë për radio me shkresën nr. 1213 prot. datë 14.07.2011. Sipas procesverbalit nr. 518 prot., datë 14.07.2011, të mbajtur nga KSHD, fillimisht është bërë verifikimi i aplikimit të subjektit. Pasi ka rezultuar se ky aplikim ishte në përputhje me kërkesat ligjore. Siç rezulton nga procesverbali i KSHD-së për frekuencën 88 MHz, kanë paraqitur interes 3 subjekte. 1. Shoqëria “City Radio Albania” sh.p.k.; 2. “Shoqëria “Together in Albanian Unione” sh.p.k. dhe 3. “Radio Ndërkombëtare e Tiranës” sh.p.k. Anëtarët e KSHD-së kanë përgatitur relacionet e vlerësimit pozitiv për secilin nga aplikantët e mësipërm.

Duke qenë se për frekuencën 88 MHz për rrethin Tiranë-Durrës, kanë konkuruar 3 subjekte (1. Shoqëria “City Radio Albania” sh.p.k.; 2. “Shoqëria “Toghether in Albanian Unione” sh.p.k. dhe 3. “Radio ndërkombëtare e Tiranës” sh.p.k.) anëtarët e komisionit kanë realizuar vlerësimin me pikë sipas kompetencës, në mbështetje të nenit 10 të rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, pika1 datë 29.08.2005 të KKRT-së, nga i cili ka rezultuar se shoqëria “City Radio Albania” sh.p.k., në total është vlerësuar me 84.7 pikë duke u renditur në vend të parë, shoqëria “Together in Albanian Unione” sh.p.k. për radion “U.A.T” është vlerësuar me 75.3 pikë, duke u renditur në vend të dytë dhe “Radio ndërkombëtare e Tiranës,, sh.p.k., për radion “R.N.T., është vlerësuar me 64.4 pikë duke u renditur në vend të tretë. Vlerësimet për aplikantët:

Drejtoritë	CityRadio Albania	TogetherinAlbanian Unione	RadioNdërkombëtare e Tiranës
Dr. Teknike	15	15	13
Dr. Ekonomike	34.7	32.3	31.4
Dr. Programeve	25	20	15
Dr.Bur.Njerëzore	10	8	5
<b>Totali pike</b>	<b>84.7</b>	<b>75.3</b>	<b>64.4</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

*Për rrjedhojë, Komisioni ka propozuar dhënien e licencës për rrethet Tiranë-Durrës, në frekuencën 88 Mhz, shoqërisë “City Radio Albania” sh.p.k. (si subjekt i renditur në vend të parë).*

KSHD ka përgatitur relacionin përmbledhës të cilin ia ka përcjellë KKRT-së, në mbledhjen e rradhës të zhvilluar në datën 25.07.2011, duke propozuar dhënien e licencës për shoqërinë “City Radio Albania” sh.p.k. për radion private vendore “City Radio Albania”, KKRT, me vendimin nr.208, datë 25.07.2011 ka miratuar dhënien e licencës për këtë subjekt.

### **6.1.6. Subjekti radiofonik “Radio 7 Nord”, shoqëria “Good Neës J-Media” sh.p.k.**

Me urdhërin nr. 347, datë 17.11.2011 të Kryetarit të KKRT-së është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe në datën 24.11.2011, është hapur aplikimi i subjektit. Shoqëria “Good Neës J-Media” sh.p.k., ka paraqitur aplikimin për licencë për radio me shkresën nr. 1870 prot., datë 24.11.2011. Sipas procesverbalit nr. 846 prot., datë 24.11.2011, të mbajtur nga KSHD, fillimisht është bërë verifikimi i aplikimit të subjektit. Pasi ka rezultuar se ky aplikim ishte në përputhje me kërkesat ligjore, ka përgatitur relacionin përmbledhës të cilin ia ka përcjellë KKRT-së, në mbledhjen e rradhës të zhvilluar në datën 30.11.2011. KKRT, me vendimin nr. 265, datë 30.11.2011 ka miratuar dhënien e licencës për shoqërinë “Good Neës J-Media” sh.p.k., për subjektin radiofonik “Radio 7 Nord”.

### **6.1.7. Subjekti radiofonik “Radio Motiv”, shoqëria “Media Motiv” sh.a.**

Me urdhërin nr.62 datë 13.03.2012 të Kryetarit të KKRT-së është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe në datën 21.02.2012, është hapur aplikimi i subjektit. Shoqëria, ka paraqitur aplikim për radio vendore në zonën rrethi Shkodër (frekuenca 98.6 MHz) me shkresën nr. 394 prot., datë 16.03.2012. Sipas procesverbalit nr. 212/1 prot., datë 18.09.2012, të mbajtur nga KSHD, fillimisht është bërë verifikimi i aplikimit të subjektit. KSHD ka përgatitur relacionin përmbledhës të cilin ia ka përcjellë KKRT-së, në mbledhjen e rradhës të zhvilluar në datën 26.03.2012. KKRT, me vendimin nr. 32, datë 26.03.2012 ka miratuar dhënien e licencës për shoqërinë “Media Motiv” sh.a., për subjektin radiofonik “Radio Motiv”.

### **6.1.8. Subjekti radiofonik “Capital Radio”, shoqëria “Capital Radio” sh.p.k.**

Me urdhërin nr. 199 datë 14.09.2012 të Kryetarit të KKRT-së është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe në datën 18.09.2012, është hapur aplikimi i subjektit. Shoqëria, ka paraqitur aplikim për radio vendore në zonën rrethet Tiranë Durrës (frekuenca 91.7 MHz) me shkresën nr. 1290 prot., datë 18.09.2012. Sipas procesverbalit nr. 625/1 prot., datë 18.09.2012, të mbajtur nga KSHD, fillimisht është bërë verifikimi i aplikimit të subjektit. Pasi ka rezultuar se ky aplikim ishte në përputhje me kërkesat ligjore, anëtarët e KSHD-së kanë përgatitur relacionet e vlerësimit sipas kompetencës dhe relacionin përmbledhës të cilin ia ka përcjellë KKRT-së, në mbledhjen e rradhës të zhvilluar në datën 24.09.2012. KKRT, me vendimin nr. 124, datë 24.09.2012 ka miratuar dhënien e licencës për shoqërinë “Capital Radio” sh.p.k., për subjektin radiofonik “Capital Radio”.

### **6.1.9 Subjekti radiofonik “Radio Glob”, personi fizik Emiljano Hoxhaj.**

Me urdhërin nr. 199 datë 14.09.2012 të Kryetarit të KKRT-së është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe në datën 18.09.2012, është hapur aplikimi i subjektit. Personi fizik Emiljano Hoxhaj, ka paraqitur aplikim për radio vendore në zonën qyteti Beratit (frekuenca 100.4 MHz) me shkresën nr. 1291 prot., datë 18.09.2012. Sipas procesverbalit nr. 625/1 prot., datë 18.09.2012, të mbajtur nga KSHD, fillimisht është bërë verifikimi i aplikimit të subjektit. Pasi ka rezultuar se ky aplikim ishte në përputhje me kërkesat ligjore. Anëtarët e KSHD-së kanë përgatitur relacionet e vlerësimit sipas kompetencës:

Vlerësimi nga zj. Sara Xhumbari për drejtorinë Juridike dhe Licencave, është pozitiv.

Vlerësimi nga zj. Shejnaze Mane, për drejtorinë Ekonomike, është pozitiv.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Vlerësimi nga zj. Olta Stasa, për drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve është pozitiv.

Vlerësimi nga z. Etjen Hanxhari, për drejtorinë Teknike është pozitiv.

Vlerësimi nga zj. Elda Shkullaku, për drejtorinë e Programeve është pozitiv.

KSHD ka përgatitur relacionin përmbledhës të cilin ia ka përcjellë KKRT-së, në mbledhjen e radhës të zhvilluar në datën 24.09.2012. KKRT, me vendimin nr. 125, datë 24.09.2012 ka miratuar dhënien e licencës për shoqërinë “Capital Radio” sh.p.k., për subjektin radiofonik “Capital Radio”.

### **6.1.10. Subjekti radiofonik “Radio Living”, shoqëria “J&P PRO” sh.p.k.**

Me urdhrin nr.45 datë 20.03.2013 të Kryetarit të KKRT-së është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe në datën 03.04.2013, është hapur aplikimi i subjektit. Shoqëria, ka paraqitur aplikim për radio vendore në zonën rrethet Tiranë Durrës (frekuenca 107.1 MHz) me shkresën nr. 773 prot., datë 03.04.2013. Sipas procesverbalit nr. 179/3 prot., datë 03.04.2013, të mbajtur nga KSHD, fillimisht është bërë verifikimi i aplikimit të subjektit. Pasi ka rezultuar se ky aplikim ishte në përputhje me kërkesat ligjore, mbështetur në pikën 16 të rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me Vendimin nr. 01, datë 29.01.2010, të KKRT-së, Komisioni vazhdoi procedurën me verifikimin e dokumentacionit të aplikimeve të paraqitura lidhur me përputhshmërinë e tyre me rregulloren “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregulloren “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, datë 29.08.2005 dhe me njoftimin e bërë në shtyp. Anëtarët e KSHD-së kanë përgatitur relacionet e vlerësimit sipas kompetencës dhe relacionin përmbledhës të cilin ia ka përcjellë KKRT-së, në mbledhjen e radhës të zhvilluar në datën 03.04.2013. KKRT, me vendimin nr. 100, datë 03.04.2013 ka miratuar dhënien e licencës për shoqërinë “J&P PRO” sh.p.k., për subjektin radiofonik “Radio Living”.

### **6.2 Inspektime e kryera në operatorët, radio e televizione privat e publik.**

Inspektimet e kryera në radio e televizione privat e publik të licensuar dhe të palicensuar për vitin 2011,2012 dhe 9/mujorin e viti 2013 rezultoi:

Programet e inspektimet nga Autoriteti Medieive autovizive për veprimtarinë e subjekteve televizivë privatë vendore, janë bërë në mbështetje të nenit 10/a dhe 137/1 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.2008 “Për Radion dhe Televizionin Publik e privat në Republikën e Shqiptarë”.

**Për vitin 2011**, me grupe pune janë inspektuar dhe vendosur 120 saksione me gjobë në vlerën 68,900 mijë lekë.

KKRT ka marë në shqyrtim ankesat e subjekteve për gjobat e vëna nga inspektimi, mbas shqyrtimit të tyre ka vendosur:

Për 49 saksione, janë hequr plotësisht gjobat në vlerë 22,200 mijë lekë.

Për 32 saksione, janë ndryshuar gjoba në vlerën 15,990 mijë lekë.

Totali i ndryshuar vlera 38,190 mijë lekë.

Vlera për tu paguar 30,710 mijë lekë nga 71 raste, paguar 6 subjekte vlerën 1,400 mijë lekë ose 5% e totalit.

**Për vitin 2012**, me grupe pune janë inspektuar dhe vendosur 118 saksione gjobe në vlerë 40,240 mijë lekë.

KKRT ka marë në shqyrtim ankesat e subjekteve për gjobat e vëna nga inspektimi, mbas shqyrtimit të tyre ka vendosur:

Për 55 saksione janë hequr plotësisht gjobat në vlerë 18,600 mijë lekë.

Për 11 saksione është ndryshuar gjoba në vlerën 3,760 mijë lekë.

Totali i ndryshuar vlera 22,360 mijë lekë.

Vlera për tu paguar 17,880 mijë lekë nga 63 raste, paguar 3 subjekte vlerën 460 mijë lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

**Për 9/mujorin e vitit 2013**, me grupe pune janë inspektuar dhe vendosur 69 saksione gjobe në vlerë 148,320 mijë lekë,

KKRT ka marë në shqyrtim ankesat e subjekteve për gjobat e vëna nga inspektimi, mbas shqyrtimit të tyre ka vendosur:

Për 27 saksione, janë hequr plotësisht gjobat në vlerë 7,420 mijë lekë.

Për 4 saksione është ndryshuar gjoba në vlerën 5,100 mijë lekë lekë.

Totali i ndryshuar vlera 12,520 mijë lekë, arkëtime për 2013 ska.

Peshën më të madhe të gjobave për 2013 e zë TV Shijaku me 18 inspektime (raste) dhe vendosur gjoba në vlerën 134,000 mijë lekë, 3 gjoba për këtë subjekt janë ndryshuar vlera 8,000 mijë lekë në 3,000 mijë lekë dy gjoba pa ndryshuar vlera 2,000 mijë lekë dhe 13 pa shqyrtuar, afati kohor i inspektimeve dhe vendosja e gjobave është nga data 04.03.2013 deri 29.04.2013.

Drejtoria Juridike dhe e Licencave ka ndjekur procedura për vendosjen e gjobave në bazë të dokumentave të paraqitura nga grupet e inspektimit.

Subjektet e ndëshkuar me saksione kanë paraqitur kërkesën në KKRT për falje e ndryshime të gjobës, kurse Drejtoria Juridike nuk i ka mbrojtur këto ndryshime me argumenta ligjore se mbi 50% e tyre janë kthyer nga gjobë në paralajmërim.

Ka subjekte që janë gjobitur në vitin 2011 dhe vitin 2012 dhe është ndryshuar masa e gjobës me paralajmërim si: Tv kab. Divjaka gjoba me nr. 336, datë 12.01.2012 vlerën 300,000 lekë, ndryshuar VM nr.56, datë 11.02.2011 nga gjobë në paralajmërim, me vendim nr. 476, datë 06.07.2012 gjobë 200,000 lekë, ndryshuar me vendim nr.103, datë 27.07.2012 nga gjobbë në paralajmërim, Tv kab.Pirg, Tv kab, Lushnja e tjerë.

Gjoba për tu paguar sipas viteve: Në vitin 2010 janë me detyrim gjobë 39 subjekte me vlerë 25,590 mijë lekë, vitin 2011 me detyrim gjobë 55 subjekte e vlerë 25,910 mijë lekë, dhe vitin 2012 me detyrim gjobë subjekte në vlerë 19,880 mijë lekë. Për tre vitet vlera 71,310 mijë lekë është mbajtur në rregjistra pa e paraqitur në pasqyrat financiare në mbyllje të vitit ushtrimor.

Në përfundim rezulton se, me ndryshimin e gjobave dhe arkëtimi në nivel shumë të ulët ka bërë që dhe efektiviteti i inspektimeve të mos jetë në shkallën e duhur, për dy vite 2011,2012 edhe mbas faljes mbi 50% e tyre nga KKRT ka mbetur vlera 45,790 mijë për pagesë dhe arkëtimi i tyre është 1,860 mijë lekë ose 4% e totalit, vlerë kjo që nuk ka mbuluar shpenzimet e paguara nga grupet e inspektimit.

Nga pasqyrave financiare rezultoi se, detyrimet që kanë radioteleviziont privat e publik ka ardhur në rritje, në vitin 2010 detyrimi ka qënë 35,004 mijë lekë, 2011 detyrimi është në 87,097 lekë dhe në vitin 2012 detyrimi është në 114,970 mijë lekë, kjo tregon dhe punë pamjaftueshme të AMA s.

Meqënëse AMA operon me të ardhurat e veta dhe plotëson nevojat për shpenzime gjatë vitit sipas parashikimeve, nuk ka bërë përpjekje e duhura për arkëtimin e detyrimeve ligjore.

Autoriteti i Mediave Audioviziv ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi nr. 782 prot, datë 02.12.2010 me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nr. 15290/4 prot. datë 01.12.2010 dhe ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2011.

**AMA ka zbatuar:** Nenin 6, ku thuhet: Njoftimi bëhet nëpërmjet një shkrese zyrtare së cilës i bashkëlidhet lista e subjektevedbitore (emëri i subjektit, vendodhja, NIPT) si dhe shuma e detyrimeve të papaguara.

Drejtoria Ekonomike ka njoftuar Drejtoritë Rajonale për detyrimet e subjekteve, por ka mbetur vetëm me njoftimin shkresorë pa bërë hapa tjera ligjore.

**AMA nuk ka zbatuar:**

**a-** Neni 5 bashkëpunimi, pika 5.2 - Për shkeljet dhe saksionet e vendosura në përputhje me nenet 137/3, dhe 137/4 të ligjit nr.8410, datë 30.09.2008 “Për Radion dhe Televizionin Publik e privat në Republikën e Shqiptarë” kur KKRT nxjerr vendimin ekzekutiv në lidhje me to mund të kërkojë mbështetjen e strukturave të Hetimit Tatimor për zbatimin e vendimit.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Veprimet e strukturave të hetimit tatimor kryhen në prezencë të inspektorëve të KKRT-së.

**b-Pika 5.4** - Veprimet për zbatimin e vendimeve kryhen në prezencë të inspektorëve të KKRT-së.

**c-Pika 5.8** - Palët do të emërojnë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit që përcakton kjo marrëveshje.

**d-Neni 7.** Të tjera në pika 7.2 thuhet: Çdo mosmarrëveshje midis palëve për shkaqe të moszbartimit të kushteve të përcaktuara me këtë marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim ose në rrugë administrative në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

**e-Ligji nr. 10279, date 20.05.2010** “Për kundravajtjet administrative” neni 46 ku thuhet: *Me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikom ndryshe, dënimi administrative, i nxjerrë nga organi i administratës publike, i cili nuk ekzekutohet me kalimin e dy viteve nga data e nxjerrjes së vendimit për kundravajtje administrative. Në këtë rast, organi administrative, që ka nxjerrë vendimin për kundravajtje administrative, me vendim konstaton parashkrimin. Me vendimin ku konstatohet parashkrimi i dënimit administrative, listohen edhe arësyet që kanë çuar në këtë përfundim.*

Në fund të periudhës (vitit) nga autoriteti nuk ka vendime për të parashkruar dënimet administrative të vendosura nga KKRT, dhe kanë plotësuar afatin kohor sipas ligjit.

### **ANEKSI B – GJETJET NGA AUDITIMI.**

#### **1.1. Gjetja nga auditimi.**

Nga auditimi i buxhetit për vitin 2011, 2012 dhe 9/M e vitit 2013 rezultoi se, nga largimin puna të 11 punonjësve janë paguar për një pozicion pune dy persona, nga vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil dhe vendimet e gjykatave periudha 01.01.2011 deri më 30.09.2013 likujduar shuma prej 14,629,828 lekë që ka sjell një efekt negativ financiar për buxhetin e institucionit, për largimet nuk janë zbatuar procedurat, në kundërshtim me Ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 për “Statusi i Nënpunësit Civil”, trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 6-7 të Projekraportit të Auditimit.

#### **1.2 Rekomandimi.**

KKRT të analizojë me përgjegjësi rekrutimin e punonjësve për vitin 2011, 2012, dhe të mos largojë nga puna punonjësit, pa shkaqe të arsyeshme dhe ligjore.

#### **1.3 Niveli i prioritetit.**

I mesëm.

#### **1.4 Përgjigja e menaxhimit të subjektit.**

#### **1.5 Afati për zbatimin e rekomandimit.**

Vazhdimisht.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

### 2.1 Gjetja nga auditimi.

Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se:

a) Në “Pasiv” grupin B nuk janë pasqyrtuar detyrimi që ka AMA ndaj tatim taksave në fund të periudhës.

*Për vitin 2011*, arkëtuar nga subjektet taksa 16,081,620 lekë, derdhur për llogari të tatim taksave vlera 15,258,049 lekë diferenca mbetur gjendje 31.12.2011 vlera 823,571 lekë, kjo duhej pasqyruar në llogarinë 432, likujdimi është bërë në vitin pasardhës.

*Për vitin 2012*, arkëtuar nga subjektet taksa 12,284,111 lekë, derdhur për llogari të tatim taksave vlera 10,398,911 lekë diferenca mbetur gjendje 31.12.2011 vlera 1,885,200 lekë, kjo duhej pasqyruar në llogarinë 432 se likujdimi është bërë në vitin pasardhës.

b) Dorzimi i pasqyrave financiare nga operatorët e radiotelevizionet private sipas nenit 8 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.2008 “Për Radion dhe Televizionin Publik e privat në Republikën e Shqiptarë”. Viti 2011 nga 220 operatorë kanë dorëzuar 128 ose 59 %, viti 2012 nga 250 operatorë kanë dorëzuar 103 operatorë ose 41 % e tyre.

### 2.2 Rekomandimi.

Drejtoria ekonomike në mbyllje të pasqyrave financiare të pasqyroje detyrimet e grupit B në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Të zbatohen hapat ligjore, për dorzimin e bilanceve nga rdiotelevizionet privat pranë institucionit.

### 2.3 Niveli i prioritetit.

I mesëm.

### 2.4 Përgjigja e menaxhimit të subjektit.

--

### 2.5 Afati për zbatimin e rekomandimit.

Vazhdimisht.

### 3.1 Gjetja nga auditimi.

Nga auditimi i pagesave për raportet mjekësore punonjësve rezultoi se nuk janë mbajtur deri në 14 ditë nuk është mbajtur tatimi mbi të ardhurat sipas ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 8483, datë 28.12.199

*“Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 8 pika b. sipas të cilit të ardhurat që i merr i punësuar për 14 dite e para me raport mjekësor, nuk janë të përjashtuara për qellim të tatimit mbi të ardhurat personale ,vlera e patatuar është 1,306,830 lekë x 10% tatimi = 130,683 lekë për 24 punonjës.*

### 3.2 Rekomandimi.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nga Drejtoria ekonomike të saktësohet, të kontabilizohet dhe të arkëtohet vlera 130,683 lekë, për 24 punonjësve sipas listës bashkëngjitur.

### 3.3 Niveli i prioritetit.

I lartë.

### 3.4 Përgjigja e menaxhimit të subjektit.

### 3.5 Afati për zbatimin e rekomandimit.

Brenda datës 20.12.2013

### 4.1 Gjetja nga auditimi.

Gjatë auditimit të arkës në lekë dhe në valutë, rezulton se arka ka qënë me gjendje më 31.12.2011 dhe 31.12.2012, kjo bie në kundërshtim me udhëzimi nr.30 datë 27.11.2011 “*për menaxhimin e vlera materiale dhe monetare*”, pra në cdo fund vitit duhet të bëhë derdhje ne bankë dhe gjendja e arkës duhet te jetë zero (0).

### 4.2 Rekomandimi.

Drejtoria ekonomike të marrë masat që në fund të vitit ushtrimore, mjetet monetare ti dorëzoi në llogarittë bankare, arka të mbetet me gjendjen 0 sipas udhëzimit.

### 4.3 Niveli i prioritetit.

I ulet

### 4.4 Përgjigja e menaxhimit të subjektit.

### 4.5 Afati për zbatimin e rekomandimit.

Në vazhdimësi.

### 5.1 Gjetja nga auditimi.

Nga verifikimi i vlerave të kaluar me xhirim nëpërmjet bankës, me urdhrat e prokurimit të nxjerrë nga titullari, për blerjeve me vlera te vogla, nuk plotësohet formulari nr. 3, për testimin e tregut,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, indryshuar, kreu VI, pika 2. “Për blerjet me vlera të vogla”.

### 5.2 Rekomandimi.

Drejtoria ekonomike mbas daljes së urdhërit të titullarit, për blerjet me vlera të vogla të plotësojë dokumentacionin e saktë e të plotë, duke bërë testimin e tregut dhe plotsimin e formularit 3.

### 5.3 Niveli i prioritetit.

I ulët

### 5.4 Përgjigja e menaxhimit të subjektit.

### 5.5 Afati për zbatimin e rekomandimit.

Në vazhdimësi.

### 6.1 Gjetja nga auditimi.

Nga auditimi i pagesave rezultoi se, punonjësve është paguar orë pune shtesë mbi kohën normale periudha Janar 2011-30.09.2013, me një vlerë **1,081,568 lekë**, të bazuar në vendimit nr.511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen në punë”, por në kundërshtim me vendimin nr.472 datë 2.07.2011 “Për disiplinimin e fondeve për orët e e punës të kryera mbi mbi kohën normale”.

### 6.2 Rekomandimi.

Nga Drejtoria ekonomike të saktësohet, të kontabilizohet dhe të arkëtohet vlera **1,081,568 lekë**, për orët shtesë sipas listës të punonjësve bashkëngjitur.

### 6.3 Niveli i prioritetit.

I lartë.

### 6.4 Përgjigja e menaxhimit të subjektit.

### 6.5 Afati për zbatimin e rekomandimit.

Brenda datës 20.12.2013



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

### 7.1 Gjetja nga auditimi.

Nga auditimi Pagesave për udhëtim e dietave të punonjësve, për shërbimet e kryera jashtë qendrës së punes, brenda vendit, në disa urdhër shërbimet ka manges të dokumentacioni shoqërues, në kundërshtim me vendimin nr.997 datë 10.12.2010 **“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohën me shërbim jashtë qendrës së punës “**, është paguar padrejtësisht vlera **232,000 lekë** për 14 punonjës.

### 7.2 Rekomandimi.

Nga Drejtoria ekonomike ë saktësohet, të kontabilizohet dhe të arkëtohet vlera **232,000 lekë**, për 14 punonjësve sipas listës bashkëngjitur.

### 7.3 Niveli i prioritetit.

I lartë.

### 7.4 Përgjigja e menaxhimit të subjektit.

### 7.5 Afati për zbatimin e rekomandimit.

Brenda datës 20.12.2013

### 8.1 Gjetja nga auditimi.

Në fund të vitit 2012 AMA ka dhënë shpërblim punonjësve nga fondi i veçantë me vlerë 1.203.195 lekë, paguar 32 punonjës, pagesa është bërë sipas vendimit nr.929 date 17.11.2010 **“Për krijimin dhe përdorimin e fondit te veçantë “**, por në kundërshtim më vendimin nr.849 datë 16.12.2012 **,ku në pikën nr 9 theksohet “Përjashtimisht për vitin 2012 fondi i veçantë nuk përdoret për shpërblimet e punonjësve.**

### 8.2 Rekomandimi.

Nga Drejtoria ekonomike të saktësohet, të kontabilizohet dhe të arkëtohet vlera 1,203,195 lekë, për 32 punonjës sipas listës bashkëngjitur.

### 8.3 Niveli i prioritetit.

I lartë.

### 8.4 Përgjigja e menaxhimit të subjektit.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

### 8.5 Afati për zbatimin e rekomandimit.

Brenda datës 20.12.2013

#### 9.1 Gjetja nga auditimi.

Nga auditimi i lëvizjeve të vlerave materiale dhe monetare rezultoi se, mungon dokumentacioni për 3,949 litra karburant me vlerë 641,273 lekë, që del si diferencë nga krahasimi i dokumentacionit me hyrje dhe daljet nga magazina, në kundërshtim me ligjin nr.6942, datë 25.12.1984, Udhëzimit nr.70, datë 11.03.1985 me ndryshime, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011. Për këtë shumë rekomandojme që shuma prej 641,273 lekësh.

#### 9.2 Rekomandimi.

KKRT me grup pune në bazë të dokumentacionit të saktësojë vlerën 641,273 lekë, dhe të nxjerrë përgjegjësitë për punonjësit që nuk kanë mbajtur dokumentacionin e duhur, të bëhet kontabilizimi dhe arkëtimi i vlerës.

#### 9.3 Niveli i prioritetit.

I mesëm

#### 9.4 Përgjigja e menaxhimit të subjektit.

### 9.5 Afati për zbatimin e rekomandimit.

Brenda datës 20.01.2014

#### 10.1 Gjetja nga auditimi.

Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se, saksionet e vendosura nga KKRT për shkeljet që kanë dalë nga inspektimet, nuk janë kontabilizuar dhe pasqyruar në bilanc, saksionet janë vendosur në zbatim të nenit 137 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.2008 “Për Radion dhe Televizionin Publik e privat në Republikën e Shqiptarë”.

*Për vitin 2011*, vlera e gjobave për tu paguar 30,710 mijë lekë nga 71 raste, paguar 6 subjekte vlerën 1,400 mijë lekë ose 5% e totalit mbeten pa arkëtuar 29,310 mijë lekë.

*Për vitin 2012*, vlera për tu paguar 17,880 mijë lekë nga 63 raste, paguar 3 subjekte vlerën 460 mijë lekë, mbeten për arkëtim 17,420 mijë lekë.

Totali për dy vite 46,730 mijë lekë, vlera këto të pa regjistruara në pasqyrat financiare.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Për arkëtimin e gjobave nuk është zbatuar marrëveshja me marrëveshjen e bashkëpunimi nr. 782 prot. datë 02.12.2010 me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nr. 15290/4 prot. datë 01.12.2010 dhe ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2011.

Nuk është zbatuar edhe Ligji nr. 10279, date 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative” neni 46.

### 10.2 Rekomandimi.

KKRT, Drejtoria ekonomike të analizojë me përgjegjësi gjendjen e dabitoreve, të saktësojë vlerën 46,730,000 lekë e detajuar sipas operatorëve dhe mbas saktësisimit të bëhet kontabilizimi i tyre, duke marrë hapat ligjore për arkëtimin.

### 10.3 Niveli i prioritetit.

I lartë.

### 10.4 Përgjigja e menaxhimit të subjektit.

--

### 10.5 Afati për zbatimin e rekomandimit.

Në vazhdimësi

### ANEKSI C – ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË MËPARSHME.

Për përmirësimin e gjendjes, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 647/6, datë 04.03.2009 “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”, ka rekomanduar për zbatim 3 masë organizative. Për zbatimin e rekomandimit të lënë, institucioni me shkresën nr. 33/3, datë 07.04.2009, ka njoftuar KLSH-në, për masat e marra.

### *Ndjekja e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.*

Nr.	Gjetjet nga auditimi i mëparshëm (01.08.2006-31.10.2008)				Zbatimi i rekomandimeve	
	Gjetjet nga i auditimi mëparshëm	Rekomandimi	Përgjigja e menaxhimit të subjektit	Afatet për zbatim	A është zbatuar Po/Jo	Impakti tek Llogaritë Financiare
1	Detyrimi kontabilizuar në vlerën 4,778,685 lekë për 27 subjekte radiotelevizivë	Të merren masat E nevojshme për Nxjerrjen e Urdhërave Ekzekutimit në Rrugë ligjore Për arkëtimin				

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE,  
MANAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

2	Kontrata nr1198/229 Datë 30.05.2005 Me UKT pa rinovuar në Mbështetje të VKM Nr. 236, datë 10.05.2003 pika 2 dhe 3	e detyrimit të kontabilizuar prej 4,778,685 lekë, nga 27 subjekte radiotelevizivë. Të rinovohet Kontrata nr1198/229 Datë 30.05.2005 Me UKT në Mbështetje të VKM Nr. 236, datë 10.05.2003 pika 2 dhe 3	Po Shkres nr 33/3 07.04.2009 Po Shkresa nr 33/3 07.04.2009	Menjëherë Menjëherë	Po Po	Po 0
3	Shpërndarja E karburantit Është bërë pa Dokumentacion Të rregullt në bazë të Urdhërit nr 4 datë 27.06.2003	Të shfuqizohet Urdhëri nr. 4 Datë 27.06.2003 i cili është kundërshtim me nr. 6942, Datë 25.12.1984	Po Shkresa nr 33/3 07.04.2009	Menjëherë	Po	0

Të gjithë punonjësve që atakohen në këtë projektraport duhet t'u bëhen prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t'u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe bëjnë vërejtje nëse kanë.

Për sa më sipër paraqitet ky Projektraport Auditimi.

**Autoriteti i Mediave Audiovizive**

**Endirë BUSHATI**

**Grupi i Auditimit KLSH-së**

**Faik QOSJA**

**Valdete BERISHA**

**Dritan KORE**